

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The Albanian

VITI I 21 I BOTIMIT 10 QERSHOR 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

SI U ZHDUK VËMENDJA PËR DIASPORËN?



PETRIT KUÇANA

**PO SIKUR NË VEND TË
PARTISË INSTITUCIONET
TË VIHESHIN NË SHËRBIM
TË SHQIPËRISË?**



ARBEN MANAJ

**STUDIMI:
BRITANIKËT
E BARDHË,
DO TË JENË PAKICË
PAS 40 VJETËSH!**


**HUMBJA
E LIBERALIZMIT**

DIMTMIR BUSHATI



**MOS ZBUKURONI
FERRIN!**

VISAR ZHITI




**SPAÇI: KUJTESA
ËSHTË E SHENJTË**

SONILA MEÇO




**ARROGANCA E ZONJËS RISTANI
DHE DËSHIRA E ZYRTARËVE PËR
NJË GAZETARI PA STANDARDE**

OLA XAMA



**RRËFIMI PËR NJË
LAGJE DHE KRYETARIN
RRËFIMTAR**

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Krejtësisht në shurdh-memecëri ka rënë 'selia rozë' (lexo partia në pushtet) pas 11 Majit.

E gjithë retorika me 'diasporë' mori fund, pikërisht në këtë datë edhe pse shumë e shumë problematika po

SI U ZHDUK VËMENDJA PËR DIASPORËN?

vihen në dukje nga opozita për votimin e diasporës.

Ngrihen goxha pikëpyetje që 'afërmendësh' shumë prej tyre mbase nuk do të mbarrim kurrë përgjigje. E nëse Greqia mbetet terësisht nën mjegullnajën e pajpjegueshmërisë, me shumë shtete të tjera 'u lanë duart' ashtu siç iu bë 'hysmeti' me mbushjen e sallave për fjalimet e kryeministrit.

Ndoshta ajo çfarë duket më interesantja e fushatës ishte se deklarimi i qartë e i saktë i komponentëve të PS-së se kishin krijuar atë që e cilësuan 'librin e diasporës'.

Partia apo Shqipëria?

Pra pas 12 vitësh në pushtet kanë krijuar listën e diasporës 'së tyre'.

Patronazhistë dhe aktivistë të të gjitha shteteve u bashkuan dhe 'mprehën shpatën / edhe njëherë për situatën' duke

'zbuluar dhe futur në regjistrin e partisë 'diasporën e tyre', pra së paku mbështetësit e tyre.

Opozita ka denoncuar formularët që iu dorëzoheshin administratës për t'i plotësuar me të afërmit e tyre nëpër diasporë, në këmbim të ruajtjes së vendit të punës.

Po sikur në vend të partisë institucionet të vëshin në shërbim të Shqipërisë?

Ata do të ishin jo vetëm afër diasporës, por diaspora do të ishte realisht pjesë



e gjithçkasë në Shqipëri dhe natyrisht nuk do të konsiderohej thjesht si 'dërguesja e parave' për të pamundurit...

Mbase kështu diaspora do të ishte jo thjesht vëzhguese por pjestare në investimet strategjike nëpër Shqipëri.

Diaspora do të ishte e mirëpritur në institucionet e shtetit shqiptar, jashtë çdo lloj detyrimi patronazhisto-aktivist.

Jo vetëm që do të ishin në 'listën e diasporës' doktorët e shkencave apo ambasadorët më të shkëlqyer të vlerave shqiptare nëpër dotë, por çdo dikaster do ta kishte nder t'i kishte pjesë qoftë edhe përkohësisht.

Të tillë janë shumë, vërtet shumë por nuk mund të pranojnë të veshin kostumin e patronazhistit.

Natyrshtëm nuk mund të jenë votësjellës të partisë, e për rrjedhojë mbesin thuasje totalisht të padëshirueshëm. Kështu nuk do të zdukej si ajo e pulës vëmendja për diasporën...

Shqipëri-Serbi u mbyll pa gola, por asnjëherë nuk mund të thuash se sfida përfundoi në paqe. "The Guardian" ka bërë një artikull për ndeshjen, ku tregon me detaje gjëra që ndodhën para, gjatë, e pas sfidës.

Prestigjiozja e njohur nuk heziton të tregojë gjithçka, që nga atmosfera në stadium, ndërprerjet e ndeshjes, sharjet e tifozëve, penalltia e humbur e Manajit e deri te vërshëllima e fundit e arbitrit

Artikulli i plotë nga "The Guardian":

Brenda "Arenës Kombëtare", mbi 20,000 tifozë mbajtën frymën dhe përqendruan çdo grimcë vëmendjeje tek Rey Manaj. Jashtë, mijëra të tjerë që kishin mbushur Tiranën gjatë gjithë ditës, disa duke pritur në radhë nëpër kufij dhe më pas duke vrapuar drejt bareve apo ekraneve publike për të ndjekur ndeshjen, shtrënguan gotat e birrës në duar. Shqipëria kishte fituar një penallti dhe askujt nuk i interesoi nëse ajo ishte e dyshimtë. Nëse Manaj do të ruante qetësinë, ndoshta më në fund do të lindte një hero i futbollit dhe mallkimi që kishte rënduar mbi këtë përballje do të zdukej njëherë e mirë.

Manaj u drejtua për të gjuajtur, ndoshta pak më i ngrirë nga sa duhej, dhe iu afrua topit ballë për ballë. Nëse kishte nevojë për një kujtesë të kontekstit, mjaftonte të dëgjonte jehonën e thirrjeve "Serbia, Serbia, motrën" që kishin qenë banda zanore e ditës dhe sapo ishin ndalur pak para se ai të merrte hapin vendimtar.

SHQIPËRI – SERBI/ "THE GUARDIAN": DETAJET E NJË NDESHJE THRILLER

Goditja ishte e ulët, shumë afër portierit serb Djordje Petrovic, i cili e priti pa shumë vështirësi. Menjëherë pas kësaj u dëgjua vërshëllima e pjesës së parë, ndërsa delegacioni serb zbriti me nxitim në fushë për të përqafuar portierin e tyre. Për Manajn, ajo që mbeti ishte vetëm një imazh i ngrirë i një momenti që nuk arriti ta përmbyste.

Në fund, kjo ndeshje arriti ta kalojë një provë të madhe, por vetëm me shumë vështirësi dhe jo pa pasoja të mundshme. Barazimi pa gola ishte gjithnjë rezultati më i sigurt për të ruajtur paqen dhe, duke pasur parasysh takimin katastrofik të këtyre dy skuadrave në Beograd gati 11 vite më parë, sukcesi i vërtetë ishte përfundimi pa incidente. Nuk pati dronë që të thyenin sigurinë e rreptë, nuk pati përlëshje që të vazhdonin në orët e vona të një nate të ngarkuar, të nxehtë dhe të tensionuar. Askush nuk mund të mburrej se kishte përmbysur rrjedhën e ngjarjeve, as në fushë dhe as jashtë saj.

Megjithatë, delegati i ndeshjes nga UEFA, ish-shefi i policisë zvicerane Jacques Antenen, kishte mjaft për të menduar teksa kalonte nëpër tribunë gjysmë ore pas përfundimit dhe ulej për të diskutuar me kolegët nga FIFA. Ai ishte zgjedhur enkas për eksperiencën e tij me ngjarje me rrezik të lartë, dhe duket se kishte shumë për të raportuar kur në minutën e 65-të, ar-

bitri Davide Massa ndaloi ndeshjen për herë të tretë.

Objekte të ndryshme kishin rënë herë pas here mbi lojtarët serbë nga tribuna lindore e stadiumit, duke detyruar zërin e stadiumit të bënte thirrje për qetësi kur Sasa Lukic u godit ndërsa po përgatitej të gjuante një këndore. Pak para minutës së 60-të, Strahinja Erakovic u godit afër vijës anësore, dhe pasoi një thirrje tjetër për ndalim. Kur edhe Andrija Zivkovic u prek në mënyrë të ngjashme, sinjalet paralajmëruese ishin të qarta.

Massa në dy raste duket se i kërkoi skuadrave të largoheshin nga fusha, por më pas zgjodhi të bisedonte gjatë me lojtarët e të dyja palëve pasi i mblodhi në qendër të fushës. Kjo përfundoi me ndërhyrjen e kapitenit shqiptar Berat Gjimeshi, i cili iu afrua sektorit nga ku kishin ardhur sendet. Policia ndërhyri menjëherë për të parandaluar përsëritjen, dhe pjesa e mbetur e ndeshjes kaloi në qetësi relative. Në fund, Massa meriton vlerësim për mënyrën si menaxhoi një situatë të papranueshme, duke kuptuar se një vendim më ekstrem mund ta kishte përkeqësuar situatën.

Kështu, një paqe e brishtë do të vazhdojë deri në tetor, kur këto dy kombëtare do të përballen sërish, dhe Serbia do të ketë për detyrë të përmbahet vetë nga elementët e saj të rrezikshëm. Nuk kishte vend për dyshime në rrugët drejt stadiumit,

sidomos në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", ku atmosfera para ndeshjes ishte ngarkuar. Shqipëria dhe Serbia do të organizojnë bashkë Kampionatin Europian U-21 në vitin 2027, por ultrasit vendas nuk ndajnë optimizmin e diplomatëve që kanë ideuar këtë bashkëpunim.

"Armiqtë e vjetër nuk bëhen miq të rinj," shkruhej në një banderolë të madhe mbi Piramidën e Tiranës, e shoqëruar nga fotografia e heroit të rezistencës shqiptare, Elez Isufi. Tifozë ngjiten mbi 100 shkallë për t'u bërë pjesë e spektaklit; të rinj me biçikleta ndezën flakadanë të kuq poshtë. Përballë, anëtarë të "Tifozat Kuq e Zi", grupi i njohur që ishte përjashtuar nga kjo ndeshje pasi nuk mori biletat e zakonshme, u përgatitën të marshonin me një pankartë që godiste Federatën Shqiptare të Futbollit.

Mesazhi i tyre ishte i qartë: "Na merrni biletat, na sillni policinë përballë, por nuk mund të vrisni zemrën që rreh për Shqipërinë." Brenda stadiumit, ata që kishin fituar në short apo që kishin paguar me mijëra euro në tregun e zi, u përpoqën ta ndezin atmosferën. Nuk dukej aspak si një ndeshje e ftohtë e ngjashme me ato të sponsorizuara kur Serbia doli në nxemje mes fishkëllimave dhe sharjeve të pandërprera. Këto vazhduan edhe gjatë himnit të tyre kombëtar, kur fëmijët që shoqëronin lojtarët serbë

Lazar Samardzic dhe Aleksandar Mitrovic bënë me duar simbolin e shqiponjës – një veprim që ka vënë në punë institucionet drejtuese të futbollit në turnetë e fundit.

Ndeshja, siç pritej, ishte e tensionuar dhe nuk tregoi shenja se ndonjëra nga këto skuadra mund t'i bëjë konkurrencë Anglisë në krye të Grupit K. Përkundër teknikës së lartë, Serbia tregoi pak rrezik përpara, ndonëse u desh një pritje e jashtëzakonshme nga Thomas Strakosha për të ndalur një goditje perfekte me kokë nga Mitrovic pas pushimit. Mitrovic humbi edhe një tjetër mundësi, por ishte Shqipëria, e shtyrë përpara nga tifozët me çdo sinjal të vogël, që duhet ta kishte fituar. Manaj e humbi rastin e tij për pavdekësi, por Nedim Bajrami duhej ta kishte bërë të harrohej ajo penallti kur iu dha një rast i pastër për të përmirësuar situatën. Goditja e tij e dobët nuk i krijoi aspak vështirësi Petrovic-it dhe përfaqësoi në mënyrë të përsosur gjithë atë që ishte kjo ndeshje.

"Meritum më shumë, por ky është futboli," tha trajneri i Shqipërisë, Sylvinho. Këto fjalë të zakonshme do të bëjnë pak për ta ngushëlluar Manajn. Por ndoshta fakti që sporti munda, sadopak, të dominojë diskutimin pas ndeshjes, është tregues se ka një rrugë më të mirë përpara, qoftë për miq, qoftë për armiqtë. /LAPSI.al

**TELEFONONI SHQIP
07468 759953**



**141 CHRISTIAN STREET
LONDON E1 1RS
TEL: 02081096550**

**A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST
I KUALIFIKUAR?**

**A DËSHIRONI
GOLD CARD?**



**18 edition - Level 3 Award in the
Requirements for Electrical
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical
Installation Inspection,
Testing, Certification and
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing
Electrotechnical Systems and
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of
Occupational Competence**



**COLLEGE OF
LONDON ME
PRONAR SHQIPTAR**



**www.collegeoflondon.org.uk
info@collegeoflondon.org.uk**



ARBEN MANAJ

1200 emigrantet qe kaluan La Manshin shenuan nje rekord te ri kalimesh ilegale drejt Britanise ne 11 muajt qe kur laburistet e Sir Keir Starmer erdhen ne pushtet!
Tanime kalimet e emigranteve duken si sherbim taksie! Numri i kalimeve vetem kete vit ka shkuar ne afro 15 mije duke i vendosur laburistet ne nje pozite qesharake kur Britania ka paguar deri me sot rreth 1 miliarde sterline Frances per te penguar gomonet qe nisen nga Franca drejt Anglise!

Vetem kete vit do japin edhe 180 milione me shume qe policia franceze te bej selfies ne brigjet franceze nga nisen gomonet, si dhe te toleroj

trafikanetet e qenieve njerezore qe te ndezin motoret dhe ngarkojne emigrantet qe i shkarkojne nga Franca dhe i derdhin ne brigjet angleze!

Opozita pro-brexit qe ne fakt inicoj daljen nga BE-ja kur kane filluar edhe kalimet ne mase ne La Mansh tani kerkon procese ligjore per marrjen Frances te financimeve qe nuk frenojne kalimet e paligjshme!

Deri me tani francezet nuk lejohet te nderhyjne ne ujrane e tyre ne momentin qe gomomonet jane ne det, edhe pse kerkohet qe te nderhyjne edhe kur ne to hypin emigrantet!

Kryeministri britanik Starmer si edhe paraardhesit e tij dukshem po sillen si naive ose si genjeshar kur premtojne ose shpresojne ne bashkepunimin francez qe skane asnje interes qe emigrantet te qendrojne ne Franca!

Starmer ka premtuar pas ardhjes ne pushtet se do aplikoj masa drastike deri duke i trajtuar si terrorist trafikantet e qenieve njerezore qe fi-



tojne miliona nga kjo tregeti cnjerezore dhe se "do thyej ne mes", bandat kriminale, nderkohe e vetmja gje qe po ndodh eshte thyerja e rekordeve te

kalimeve ilegale neper La Mansh!

Ne kushtet kur Britania po harxhon miliarda per mbrojtjen e ishullit nga

sfidat nderkombetare, duket se nuk eshte ne gjendje te mbroj kufijte e saj detar nga grupet e krimit te organizuar! topchannel

Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund te vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

**TRANSPORT
APOLLONIA**



**TRANSPORT
MAKINASH
ANGLI-SHQIPËRI**

00447429200952

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI
MAKINA
MOTORCIKLETA
PJESË MAKINASH
MAKINERI BUJQËSORE
MOBILJE
FASADA XHAMI
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



00355682948843

00355694031009

00447429200952

**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-SHQIPËRI
SHQIPËRI-ANGLI**



www.transportapollonia.co.uk



ARBEN MANAJ

ANGLI, DISKUTOHET FEREXHEJA/ DEPUTETJA E RE E SURPRIZON STARMERIN

Retorika anti-myslymane deri ne kerkesa per heqjen e ferexheve qe dikur ishte e pranishme ne Frances, Belgjike apo Danimarke, tashme mbrine ne ishull, dhe per habit e askujt, ajo formulohet nga nje deputete e parties Reforma, nje parti me retorike mjaft te forte anti-emigracion, e drejtuar nga babai I Brexit, Nigel Farage.

Ka qene deputetja me e re e parlamenti e zgjedhur vetme nje muaj me pare ne zgjedhjet e ribera pas largimit ten je depeuteti laburist, ku kandidatja e parties Refeorma fitoje ne bastionin e 16 me te sigurt te Laburisteve. Sarah Pochin, e njohur si mbeshtetese e fuqishme e Farage, shtangu kryeministry britnaik Saterme ne interpelancene paralmenare kur duke

kerkura ndlaimin e ferexhes, apo burkas, ju drejtua me fjalet; nisur nga deshira e kryeministrit per te forcuar perafirimin strategjike me fqinjet tane evropiane ne interesin publik, a do ti bashkohej ai Frances, Danimarkes, Belgjikes dhe vendeve te tjer per ndlaimin e ferexhes?

Por Starmer, duke shmangur dhe injoruara haptazi nje kerkse te tille, u kundergjigjei: A mund ta mirepreszonjen te ulet ne vendin e saj, Por nuk do e ndjek Qasjen e saj”.

Kjo eshte hera e pare qe nje kerkese e tille behet ne nje vend ku rreth 9 perqind e popullise eshte e fese myslymane dhe tolernaca fetare eshte

mjaft e spikatur.

Partria Reforma, me narrative te forte kseneofobe dhe anit-emigracion, ka vetem 5 deputete ne parlamentin e ri britanik, por mbeshtetja e saj ne public sipas sondazheve mbetet e larte, per shkak sa te trashegimise se problematiaveve nga qverisja katastrofale 15 vjecare e konservatoreve nga rradhet e te cileve ka marr shume mbeshtetes, por edhe nga te labruis-teve.

Gjasat per ndalimin e ferexhes ne Britani relaisht jane te pakta sa per shkak te kohezionit shoerore ne vend por edhe per kalkulime politike dhe elektorale.



Permes analizave te ritmit te lindjeve dhe vdekjeve si dhe shifrave te emigrimit deri ne fund te shekullit te 21, parashikohet se popullisa e bardhe ne Britani do jete pakice pas afro 40 vjetesh ose me sakte ne vitin 2063. Aktualisht 73 perqind e popullise britanikeve eshte e bardhe.

Sipas nje studimi te nje profesori te Univeristetit te Birmingamit dhe prezantues i stacionit televiziv, GB Neës, shume i afert me liderin e partise Reforma, ose partise se babit te Brexit, Nigel Farage, projektohet nje rritje e rendesishme e indivdeve te lindur jashte Britanise

apo qe jane emigrante te brezit te dyte, duke u rritur nga poshte 20 perqindshit ne 33.5 perqind brenda 25 viteve te ardhshme.

Keshtu ne vitin 2100 raporti sugjeron se 60 perqind e britanikeve do kete te pakten nje prind emigrant ose ai ose ajo, nuk do jete i lindur ne Britani. Popullsia mysly-

mane vleresohet te rritet ne 19.2 perqind deri ne fund te shekullit kur aktualisht eshte 7 perqind e popullise ne Britani. Sipas autorit te raportit, Matt Goodëin, te Univeristetit te Birmingamit, nje kohe-sisht prezantues televiziv prane televizionit te afert me partine e Brexitit, deri “ne fund te shekullit te tanishem shumica e popullise ne

keto ishuj nuk do jete ne gjendje te gjumojne rrenjet gjenealogjike ne kete vend per me shume se dy dekada”.

Ne vitin 2022 eshte mesuar se Londra dhe Birmingami jane shnderuar ne qytet ku popullsia e britanikeve te bardhe eshte minoritet. Do ishte spekulim te thuhej se nje studim i tille i bere

nga nje akademik i lidhur me nje medium pro parties se Brexit, me nje narrative te forte antimigratore, nuk ka elemente te verteta dhe qe me teper te injorohet, kur vet krye-einistri Starmernisur nga demografia ne vend ka folur para nje muaji per shnderimin e Britanise ne nje “ishull i te huajve”.

A. Manaj

STUDIMI: BRITANIKËT E BARDHË, DO TË JENË PAKICË PAS 40 VJETËSH!

Dotech

website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929




Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian



**NESE JU DUHET NJE DOKTOR
MOS HEZITONI TE VIZITONI
VAL CLINIC**

THE BEST MEDICAL CENTER

OUR SERVICES:

CARDIOLOGY

ENT

PAEDIATRICS

GYNAECOLOGY

DERMATOLOGY

INTERNAL MEDICINE

RADIOLOGY

PHYSIOTHERAPY

NEUROLOGY

SURGERY AND MINOR INJURY

UROLOGY

ENDOCRINOLOGY

GASTROENTEROLOGY

AESTHETIC MEDICINE

PODIATRY

FULL CHECK-UP

PSYCHOLOGY

PSYCHIATRY

DIAGNOSTICS:

ALL TYPE OF BLOOD TEST

AND SWABS AFTER

DOCTORS

CONSULTATION



**Pershendetje,
Dr. Arjola KURTI
dhe Dr.Val punojnë
në VAL Clinic që është një
klinikë në Londër me mjek/e
specialistë të gjithë
sherbimeve mjekesore.
Për çdo problem
na kontaktoni**

NA KONTAKTONI



INFO@VALCLINIC.CO.UK

WWW.VALCLINIC.CO.UK

**39 Frederick Road
Rainham RM13 8NJ**

Tel: 01708701155

Mob: 07307595437

FSHATRA TË QETË, LUMENJ TË EGËR DHE AVENTURA TË PAZAKONTA, THE TIME: ANA SEKRETE E JUGUT TË SHQIPËRISË

Pothuajse 12 milionë njerëz vizituan Shqipërinë vitin e kaluar, shumë prej të cilëve u drejtuan për në rivierë me premtimin e një pushimi të përballueshëm në plazh, të mbushur me diell. Por e vërteta është se turizmi i tepërt tashmë po afrohet, çmimet po rriten dhe investimet ndërkombëtare - përfshirë ato nga Jared Kushner, dhëndri i Presidentit Trump - do të thotë se fshatrat tradicionale po zhvillohen në vendpushime plazhi.

Nëse perspektiva e rrezitjes disa metra larg familjes Trump ose e të qenit në një hotel që mund të jetë kudo në botë ju dekurajon, ekziston një pjesë e rivierës shqiptare që gjigantët e pushimeve me paketa dhe manjatët e hoteleve kanë tendencë ta humbasin. Undiscovered Balkans, një kompani e vogël britanike udhëtimësh që specializohet në aventura të pazakonta, ka prezantuar një turne në grupe të vogla për të nxjerrë në pah disa nga thesaret më pak të përmendura të jugut të Shqipërisë.

U bashkova me udhëtimin në maj dhe kalova një javë duke eksploruar qytete bregdetare më pak të njohura përpara se të zhytesha në brendësi të vendit, ku vizitova vendet e trashëgimisë botërore të UNESCO-s, notova në ujëvara të fshehura, qendra me fermerë lart në male dhe lundrova me rafting në një nga lumenjtë e fundit vërtet të egër të Evropës. Ne e përfunduam udhëtimin në plazhe me guralecë pa turma, 200 metra mbi nivelin e detit, në një fshat peshkatarësh në brigjet e Liqenit të Ohrit.

Mbërrita në Qeparo, një nga fshatrat më të qetë bregdetarë në qarkun e Vlorës, në errësirë pas një udhëtimi tre-orësh me makinë nga Tirana. U zgjova me pamje nga Qeparo e Vjetër, fshati origjinal bujqësor në shpatin e kodrës, që zbriste poshtë malit për të takuar Qeparoin e Ri në bregdet, ku baret e plazhit dhe qendrat e qirasë së varkave po përgatiteshin për sezonin.

Mikpritësja jonë ishte Mirella Kokëdhima e mrekullueshme, e cila drejton bujtinën në fermën e saj në majë të kodrës, diku midis dy Qeparove. Ajo që mundi të gatuante pas një stuhie të fortë dhe ndërprerjes së energjisë që rezultoi ishte mbresëlënëse dhe e bërë me një buzëqeshje. Vezë, djathë dhie, kos, sallatë, ëmbëlsira me çokolatë të bëra në shtëpi, salçiqe dhe kafe turke aq e trashë sa mund ta përtpypte, të gjitha erdhën drejt nesh.

Në këtë fillim të sezonit, deti ishte shumë i trazuar për të bërë kajak, kështu që e kaluam ditën e parë duke ecur përgjatë bregdetit. Grupi ynë prej tetë britanikësh, me moshë nga tridhjetë deri në gjashtëdhjetë vjeç, bredhi përgjatë shkëmbinjve gëlqerorë karstikë me pamje epike të fshatrave tradicionale dhe ujit të gazuar, Korfuzi një kodër e mjegullt përtej gjirit. Aroma e luleve të egra dhe trumzës varej në ajër dhe zogjtë cicëronin nga degët aty pranë. Nëntë



milje më vonë zbritëm në plazhin e Borshit dhe i zhytëm këmbët e lodhura në ujin e freskët të Jonit, me një birra të merituar në dorë.

Të nesërmen i kthym shpinën bregdetit dhe iu bashkuam guidës sonë, Alf Pepaj, në një 4x4 për një aventura piktoreske jashtë rrugës përmes maleve drejt Gjirokastrës, një qytet i epokës osmane i mbrojtur nga UNESCO. Pamja ishte e gjitha dramatike, maja të mbuluara me qilim të gjelbër dhe livadhe të gjera e të hapura, pa askënd përreth për kilometra të tëra. Gjatë rrugës, ndalua në mes të asgjësë dhe ndoqëm Pepajn poshtë në një kanion, ku binte një ujëvarë.

Fshatra të qetë, lumenj të egër dhe aventura të

Një orë a më vonë mbërritëm në Gjirokastrë dhe u magjepsëm menjëherë. Akomodimi ynë ishte një hotel karakteristik brenda një shtëpie osmane me mobilje që i përshtatshin. Në ditët e sotme, shumica do ta njohin Gjirokastrën për qytetin e saj të vjetër tradicional dhe pazarin, i cili ngjan me Mostarin e Bosnjës ose Krujën e Shqipërisë veriore. Por qyteti ishte gjithashtu vendlindja e Enver Hoxhës, diktatorit brutal komunist që sundoi Shqipërinë për 40 vjet deri në vdekjen e tij në vitin 1985. Është çudi se si një njeri kaq i lig mund të vinte nga një vend kaq i bukur dhe paqësor.

Kalaja e shekullit të 13-të, e ruajtur në mënyrë të mrekullueshme, e Gjirokastrës ofron pamje të gjera të rajonit dhe muret e saj të freskëta prej guri ofrojnë pushim nga vapa e verës. Qyteti është shumë i njohur për turistët, por çmimet ishin të arsyeshme

dhe një Aperol spritz më kushtoi vetëm 6 paund.

Të nesërmen në mëngjes u nisëm përsëri për në male në një tjetër turne 4x4 ku na priste më shumë nga ai peizazh spektakolar karstik. Ne udhëtuam përgjatë shtigjeve marra-mendëse drejt fshatit Hoshtevë në Zagoria, qarku fqinj. Disa ndalesa për foto më vonë, ne zbritëm kodrën drejt një kisha fshati të shekullit të 12-të, e cila strehon disa nga afresket dhe ikonat më të ruajtura të Shqipërisë, të cilat i kanë mbijetuar disa luftërave, Perandorisë Osmane dhe diktaturës së Hoxhës.

U kthym në shtëpinë e mysafirëve të Kristinës dhe Ladi Telos për një tjetër festë shqiptare. Hëngrëm në verandën e tyre rrethuese, e cila ishte e zburuar me lule, pemë agrume dhe fole dallëndyshesh, asnjë zë apo shpirt tjetër në horizont për kilometra të tëra. Nuk mund ta besoja sasinë e ushqimit (të freskët) që vinte nga një kuzhinë jo më e madhe se qilaret e shumicës së njerëzve.

E mbushur siç duhet dhe me Pepajn që përkthente, filllova të flisja me Kristinën dhe zbulova se e kishin shndërruar shtëpinë e tyre në një shtëpi mysafirësh 12 vjet më parë, pasi pashë një treg për ushqimin dhe strehimin e shëtitësve që kalonin anej. Një gjë çoi në një tjetër ndërsa Kristina më tregoi përreth dhe gjëja tjetër që dija, po provoja veshjen e saj tradicionale të bareshë dhe po ia modeloja atë pjesës tjetër të grupit.

Qëndrimi ynë i radhës ishte në një shtëpi fshati 120-vjeçare të restauruar me pamje nga lugina e Vjosës, ku

rrjedh Vjosa, një nga lumenjtë e fundit vërtet të egër të Evropës. Për të mbërritur atje, kishim ngarë makinën duke u ngjitur në një shteg shkëmbor dheu, or ia vlejti munda. Tani një ndërtesë e mbrojtur, shtëpia e familjes së Kristaq Cullufes pati fatin të mos u sekuestrohej nga komunistët dhe për një kohë të gjatë mbeti e braktisur. Fshati është një hije e vetes së tij të mëparshme, me shumë njerëz që janë larguar për të gjetur punë diku tjetër.

Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, familja e Cullufes u kthye nga qyteti i afërt i Përmetit dhe nisi restaurimin e shtëpisë fshatare. Në dhomën e gjumit në katin e parë ndodhej paja e nënës së tij, një arkë prej druri që nuset shqiptare e mbushnin me gjëra për t'i marrë me vete në shtëpinë e tyre martesore. Në oborr, ku hanim nën tingujt e Vjosës që shpërthente nëpër luginën poshtë, kishte më shumë objekte, duke përfshirë vegla të vjetra bujqësore, makina qepëse dhe telefona.

Më shumë nga ai peizazh malor baritor mbushi dritaret tona të nesërmen, ndërsa udhëtonim drejt Liqenit të Ohrit, ndalesa jonë e fundit. Por jo para se të argëtoheshim në Vjosë, duke bërë rafting në ujëra të bardha, duke zhytur në shkëmbinj dhe duke notuar në natyrë. Mbërritëm përsëri në errësirë, duke i lënë pamjet buzë liqenit një surprizë deri në mëngjes.

Fshatra të qetë, lumenj të egër dhe aventura të

I shtrirë përgjatë kufirit me Maqedoninë e Veriut, Ohri i mbrojtur nga UNESCO është një nga liqenet më të vjetra të Evropës. Ne qëndruam në

fshatin e qetë të peshkimit të Linit, i cili është një destinacion turistik në hapat e tij të parë dhe Iloji i vendit ku njerëzit kanë një varkë në vend të një makine.

Dita jonë e fundit ishte aktive, duke bërë ecje dhe kajak në plazhe të izoluar me guralecë në mëngjes dhe duke përshkuar me biçikletë gjatësinë e pjesës së liqenit që i takon Shqipërisë në pasdite. Nuk ka shezlongje të shtrenjtë këtu. Udhëtimi i këndshëm prej 19 kilometrash na çoi pranë tokave të mbjella, bunkerëve të mbuluar me bimësi, enklavave të qeta ku rosat kërcisnin pas kallamishteve dhe peshkatarëve që shisnin peshkun e tyre buzë rrugës.

Ndaluam në qytetin më të madh të Pogradecit, i cili ka një ndjesi të vërtetë bregdetare britanike: fëmijët qeshën në lojërat e panairit, aroma e karamelëve dhe petullave përhapej në ajër dhe të moshuarit pëthithnin cigare dhe pinin raki ndërsa luanin damë në shtëtorë. Pogradeci është një qytet turistik që ka gjetur ekuilibrin e duhur me turizmin - të zhurmshëm, por jo shumë të mbushur me njerëz.

Nëse preferoni të kaloni pushimet tuaja duke pushuar në plazh duke pirë kokteje, ky udhëtim ndoshta nuk është për ju. Por nëse doni të përjetoni një anë më autentike të Shqipërisë, me aventura në natyrë dhe shkëmbime kulturore të paçmuara, mund të jetë.

Laura Sanders ishte një mysafire e Balkans Undiscovered, e cila ofron shtatë netë me pagesë të plotë nga 1,195 £ për person në një festë me aktivitete në Shqipërinë e Jugut. Përshatur nga The Times

“

Jeta ime e re, në mënyrë të paligjshme, në Mbretërinë e Bashkuar nuk ishte ajo që kisha shpresuar

”



Premtimet dhe shpresat për një udhëtim të lehtë dhe një të ardhme më të mirë besohen shpesh, por realiteti për emigrantët e paligjshëm, siç e përjetoi një 31-vjeçar nga Veriu i Shqipërisë, është shumë më sfidues.

Ai e kishte piksynuar Mbretërinë e Bashkuar (MB) - një vend të cilin e lidhte me mundësi të barabarta, zhvillim profesional dhe që ofronte mjete dhe mënyra për një përmirësim të stabilitetit financiar. Megjithatë, ai zgjodhi rrugën e rrezikshme dhe të pasigurt duke hyrë në mënyrë të paligjshme, njëkohësisht duke marrë parasysh pasojat ligjore apo sfidat e jetesës në MB pa dokumentacion të rregullt.

“Sapo arrita në MB unë u përballa me shumë pengesa dhe shumë shpejt e kuptova se ishte shumë më e vështirë nga sa kisha shpresuar. Nuk mora asnjë informacion rreth ligjeve apo pasojave ligjore dhe, sinqerisht, nuk i kushtova shumë vëmendje – në atë kohë, thjesht, unë doja të largohesha nga jeta që kisha në Shqipëri.”

Pas një marrëveshjeje me disa kontrabandistë, udhëtimi i tij nisi me makinë drejt një zone në bregdet. Menjëherë filloi të ndjente një ankth

dhe frikë. Ai nuk kishte asnjë mënyrë për të ditur nëse kontrabandistët do t'i mbanin premtimet, nëse do të grabitej, do të braktisej apo më keq.

“Ishte e rrezikshme. Mbasni në u dhamë paratë, ata na çuan me makinë drejt bregut, ku ndodhej varka. Gjatë udhëtimit me makinë, mua më mbërtheu një ankth sepse nuk dinim ku po na çonin, nëse na ndiqte dikush, apo nëse nuk do t'ia arrinin të largoheshim. Ishte një ndjesi e rrezikshme.”

Pastaj erdhi udhëtimi me një varkë të vogël. E mbingarkuar dhe e pajisur keq, varka ishte plot me emigrantë - shumë prej të cilëve dukeshin të frikësuar, sidomos kur hynë në ujërat e rrezikshme të Kanalit Anglez. Pa asnjë vijë bregdetare në horizont dhe me kërcënimin e vazhdueshëm të përmbajtjes, atë e pushtoi frika dhe pasiguria.

“Në varkë, mua më mbërtheu një ankth i madh dhe ndjehesha i vetmuar... ishte e tmerrshme. Ajo ishte mbushur me njerëz por unë kisha ndjesinë se brenda në ‘të kishte më shumë njerëz se sa ajo duhej të mbante në të vërtetë...”

Realiteti i jetës në MB ishte shumë më i ashpër nga sa ai e kishte imagjinuar. Si një emigrant pa

dokumente, ai nuk kishte të drejtë të punonte apo të merrte ndonjë dhomë me qira për veten e tij. Gjatë gjithë kohës ai jetonte në frikë të vazhdueshme se mos kapej nga autoritetet.

“Nuk kisha të drejtë të punoja lirshëm. Unë nuk kisha mundësi as të lëvizja lirshëm pasi ishte frika se mos më kapte policia. Kjo frika e të përherëshme se mund të më kapnin, ngaqë isha i paligjshëm në MB, u kthye në një makth dhe më bënte të ndihesha shumë keq. Kuptova që nuk mund të merrja as një dhomë me qira... Fillova të ndihesha gjithnjë e më i izoluar. Për arsye se unë nuk kisha akses në tregun e punës apo të punoja lirshëm, siç kisha shpresuar, kushtet mia të jetesës ishin të këqija.”

Nuk kishte kaluar asnjë muaj dhe, duke kuptuar se jeta që kishte ëndërruar në MB nuk ishte e arritshme për një emigrant të paligjshëm, ai ra në depresion dhe në një gjendje vetmie të thellë.

“Pasi u përballa me shumë pengesa, rashë në depresion. Sigurisht që më merete malli për familjen dhe shokët, sepse në vendin tënd i ke të gjithë aty. Brenda një muaji, për mua u bë e qartë që kjo nuk ishte ajo që kisha

shpresuar apo besuar për jetën time të re në MB. Unë nuk do t'ia rekomandoja askujt vajtjen në mënyrë ilegale në MB.”

Duke u bazuar nga përvoja e tij personale, tani ai është një këshillues i fuqishëm kundër migrimit të parregullt (pa dokumente). Rreziqet, si ato fizike ashtu edhe psikologjike, e tejkalojnë ndjeshëm çdo përfitim të mundshëm.

Përvoja e tij e ka bërë atë të angazhohet për të promovuar mënyrat për të gjetur rrugë të ligjshme emigrimi. Ai i këshillon shokët, të afërmit e tij dhe komunitetin në përgjithësi, që ata të kërkojnë viza dhe të ndjekin procedurat zyrtare.

“Unë do të rekomandoja aplikimin për një vizë pune apo ardhjen në MB në mënyrë të ligjshme. Nuk do të ketë asnjë vlerë vajtja në mënyrë ilegale në MB pasi do të përballesh me shumë pengesa – nuk do të kesh mundësi të marrësh as një dhomë me qira, e lëre më të punosh.”



Varkat e vogla nuk janë të përshtatshme dhe shumë prej tyre prishen në udhëtimin e gjatë e detin me dallgë në Kanal Anglez.

Që nga korriku 2024, pothuajse 30,000 persona, pa të drejtë qëndrimi në MB, janë kthyer mbrapsht. Si rezultat i shtimit të masave të zbatimit të ligjit për emigracionin në MB, që nga korriku 2024, azilkërkues të refuzuar, kriminelë të huaj dhe shkelës të tjerë të rregullave të imigracionit janë riatdhesuar në Afrikë, Azi, Europë dhe Amerikën Jugore. Ky numër i madh nxjerr në pah qasjen gjithnjë e më të ashpër të qeverisë – si për të penguar aktivitetet ilegale, ashtu edhe për të reduktuar rreziqet që vijnë nga mënyrat e rrezikshme të udhëtimit.

Udhëtimi i paligjshëm drejt MB-së rrezikon jetën tuaj ndërsa ndjekja e rrugëve ligjore do t'ju japë mundësi që të mos e lini të ardhmen tuaj në duart e kontrabandistëve dhe të pasigurisë.

Për më shumë informacion vizitoni:
gov.uk/immigrationfacts



#BreakingTheChains

Forest Gate Youth Club

Immigration advise

Sports & Dancing

Peer support

General info and support


Come Dine with Me



Join us

every Monday evening 6-9pm

 1 Woodford Road,
Forest Gate,
London, E7 0DH

 07494974957


Shpresa Programme

Inspiring hope & change

Akoma nuk keni një Website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

OUR SERVICE :

- Business Cards
- Banners
- Video Marketing
- Logos
- Etc

Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të vini nga zyrat tona

Adresa e zyrave
30 Avenons Road,
London E13 8HT



Na kontaktoni

Tel: 020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545



DITMIR BUSHATI

Nëse do të duhet të shpjegojmë me një fjali rezultatin e zgjedhjeve presidenciale në Poloni, mund të thuhet se progresistët dhe përballë konservatorëve, në atë që mund të konsiderohet si ballafaqimi më i rëndësishëm zgjedhor i vitit në Europë. Si në shumë demokraci europiane, rezultati na tregon një komb të ndarë thuasht në mes midis konservatorëve dhe progresistëve, midis nacionalizmit dhe internacionalizmit liberal. Dhe një brez të ri të tradhtuar nga qendra demokratike, që gjithnjë e më shumë e shoh veten tek e djathta apo e majta ekstreme.

Një rezultat, që megjithëse është i ngushtë, ngjan me një brisk të hollë, thellësisht përçarës. Dy vjet më parë, koalicioni shumëngjyrësh i udhëhequr nga ish-Presidenti i Këshillit Europian dhe një prej veteranëve të politikës polake Donald Tusk, i dha fund pushtetit tetëvjeçar të partisë konservatore Ligj dhe Drejtësi.

Qeveria "Tusk" parashtrori dy përparësi të mëdha: (i) rivendosjen e besimit të publikut në institucionet demokratike; (ii) zbutjen e polarizimit politik e shoqëror. Në të dyja duket se dështoi. Historia e Europës ka plot shembuj të transformimit politik drejt demokracisë, si nga autoritarizmi i krahut të djathtë (Portugali, Spanja, Greqia) ashtu edhe nga komunizmi (ish-Blloku Lindor) ose nacional-socializmi (Gjermani, Austri). Por, tejkalimi i një sistemi joliberal që u çimentua gjatë viteve në pushtet të partisë konservatore Ligj dhe Drejtësi, në një mënyrë liberale, ishte një territor i pashkelur, që në rastin e Polonisë u shoqërua me sfida më të mëdha se në rastet e mëparshme.

Me rikthimin në pushtet në vitin 2023, qeveria "Tusk" paraqiti një plan refor-

HUMBJA E LIBERALIZMIT

mash që synonin "rivendosjen e demokracisë liberale" dhe kthimin e Polonisë në zemër të zgjimit gjeopolitik të Europës për t'u përballur me kërcënimin e shtuar rus. Pavarësisht mbështetjes që erdhi nga Komisioni Europian dhe shfuqizimit të masave shtërnguese që BE-ja kishte vendosur ndaj Polonisë, për moszbatimin e standardeve të shtetit të së drejtës, dy pyetje mbeten pa përgjigje në rrugëtimin e qeverisë "Tusk": Mbi çfarë baze duhet të bëhet rindërtimi institucional? A justifikon situata e jashtëzakonshme mjete të pazakonta, apo mjete që testojnë kufijtë e legjitimitetit? Te përgjigjet e pyetjeve të mësipërme mund të gjenden edhe një pjesë e arsyeve se përse kandidati i koalicionit qeveritar, kryetari i Bashkisë së Varshavës, Rafał Trzaskowski, nuk arriti të bindte shumicën e votuesve dhe ç'është më shtetëse, shumicën e të rinjve, që të përfaqonin agjendën proeuropiane dhe liberale.

Karol Nawrocki, një figurë e panjohur dhe pa eksperiencë politike e ndërkombëtare, arriti të fitojë besimin e shumicës së polakëve, përmes një rrëfimi të përqendruar në vlerat konservatore, sovranitetin dhe mbrojtjen e traditave polake. Përplasjet mes dy kampeve kryesore politike në Poloni ngjasojnë me lavjerrësin që herë shkon para e herë shkon pas. Edhe pse qeveria është përgjegjëse për përcaktimin e politikës së jashtme, të mbrojtjes dhe ekonomisë, presidenti ushtron veton mbi legjislacionin kyç, duke përfshirë buxhetin dhe politikën e emërimeve në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe drejtësisë.

Duke pasur parasysh fuqitë e vetos së presidentit, sikundër kampet politike të ndryshme që presidenti dhe qeveria përfaqësojnë, mund të thuhet se përplasja e hidhur midis tyre, medias dhe pjesëve të shoqërisë që i mbështesin ato, do të vazhdojë e pandërprerë deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2027. Të gjitha lëvizjet në poli-

tikën polake do të orientohen për nga këto zgjedhje, duke e bërë bashkëjetesën politike midis presidentit dhe qeverisë gjithnjë e më të vështirë. Si një anëtar kyç i BE-së dhe NATO-s, sherrret e brendshme në Poloni mund të kenë ndikim në kapacitetin e BE-së dhe NATO-s për t'u përballur me kërcënimin rus.

Në këtë situatë të re politike, marrëdhëniet polako-ukrainase do të shërbejnë si letër lakmuesi. Presidenti i rikundërshon anëtarësimin e Ukrainës në NATO dhe BE, duke shënuar një ndarje me qëndrimin e kahershëm të Polonisë. Kjo mund të dobësojë aleatët në vijën e parë, të cilët e kanë konsideruar përpjekjen e Ukrainës për anëtarësim në strukturat euro-atlantike si një përparësi strategjike afatgjatë. Me interes pritet gjithashtu pozicioni i Polonisë brenda këtyre organizatave në raport me SHBA-të, kur dihet se presidenti i zgjedhur u mbështet nga SHBA-të dhe madje u prit në Shtëpinë e Bardhë në prag të zgjedhjeve, ndërkohë që rivali i tij u mbështet nga udhëheqësit kryesorë europian.

Deri tani Polonia është shfaqur si një avokate e zëshme për forcimin e bazës industriale të mbrojtjes të BE-së, që nënkupton forcimin e autonomisë strategjike të Europës dhe rritjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Presidenti i ri pritet të konfirmojë qëndrimin e vazhdueshëm të Polonisë, duke përfshirë shpenzimet e mbrojtjes dhe modernizimin ushtarak, pasi lidhja e tij e ngushtë me SHBA-të sugjeron mbështetje të fortë për NATO-n. Në të njëjtën kohë, ai ka të ngjarë të mbështesë ndihmën ushtarake për Ukrainën, pasi fitorja e Ukrainës është jetike për interesat e Polonisë. Gjithsesi, mbetet të shihet se cila do të jetë qasja e tij në rast se politika e Presidentit Trump për të shkëputur Rusinë nga Kina do të realizohet në praktikë me çdo çmim (përfshirë edhe Ukrainën). Presidenti i ri pritet të sfidojë agjendën e institu-

cioneve mbikombëtare të BE-së duke përforcuar rrëfimin sovranist të partisë konservatore nga radhët e të cilave vjen.

Edhe pse qeveria polake është përgjegjëse për përcaktimin e qëndrimeve në BE, presidenti ka ndikim në formësimin e opinionit publik. Ndërsa Presidenti Nawrocki mund të mos jetë në të njëjtën gjatësi vale me kryeministrin hungarez Viktor Orbán dhe atë sllovak Robert Fico, duke pasur parasysh dallimet e konsiderueshme rreth Rusisë, ata ka të ngjarë të jenë aleatë në formësimin e opinionëve dhe qëndrimeve alternative brenda BE-së.

Thënë ndryshe, për Europën, ky rezultat do të thotë se një nga vendet e saj kryesore, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen europiane, të ardhmen e Ukrainës dhe përballjen me kërcënimin rus, do të jetë një partner më i dobët dhe më pak i bashkuar si në BE, ashtu edhe në "koalicionin e vullnetit" të përbërë nga "trekëndëshi i Weimar" (Gjermani, Francë, Poloni) dhe Mbretëria e Bashkuar. Vështuar në një plan më të gjerë përtej kontekstit polak, ky rezultat është dëshmi e krizës me të cilën përballen forcat që i mëshojnë demokracisë liberale me mendësinë e Luftës së Ftohtë. Një humbje për liberalizimin.

Ndarja e thellë në Poloni pasqyron një prirje në të gjithë Perëndimin që ka të bëjë me dobësimin e koalicioneve të qendrës demokratike, që dikur mbështesnin qeverisjen liberale, veçanërisht në dekadat pas rënies së Murit të Berlinit. Mirëpo, gjeopolitika e pas rënies së Murit të Berlinit zbehu mjetin kryesor që mbante në këmbë liberalizmin: avantazhin e qartë përkundrejt kundërshtarëve joliberal.

Asokohe, ngjithësi që e mbante këtë koalicion të bashkuar nuk ishte qëndrueshmëria dhe kohezioni i brendshëm, por diferenca me armikun e jashtëm. Institucionet mbikombëtare dhe qeverisja teknokratike, shpesh të izoluar nga llogaridhënia e drejtpërdrejtë demokratike, shiheshin si forca stabilizuese, thelbësore për sigurinë dhe prosperitetin afatgjatë. Sakrificat e kërkuara nga demokracia liberale pranoheshin si më të prefer-

ueshme sesa kostot e dorëzimit ideologjik. Sot nuk shihen më si të tilla. Në librin e sapo botuar "Çfarë mësova për Brexit dhe një prej politikaneve më të spikatur francez Michel Barnier, drejtimin nga Ursula von der Leyen të Komisionit Europian e përshkruan si "prirje autoritariste".

Ndërsa Komisionin Europian, si thellësisht burokratik, centralizues dhe të pandjeshëm ndaj interesave të qytetarëve.

Kur një konstatim i tillë vjen prej një politikani të nivelit të lartë europian, është i kuptueshëm dividenti politik që grumbullohet nga parti konservatore apo populiste në shumë vende të BE-së, në emër të interesit kombëtar, traditës dhe sovranitetit. Koalicionet që promovojnë demokracinë liberale nuk janë thjesht viktimë e elektoratit të pakënaqur, por gjithashtu vuajnë nga mungesa e një oferte bindëse për trajtimin e njëmendtë të reformave që kanë të bëjnë me demokracinë dhe shtetin e së drejtës, pabarazitë ekonomike që vijnë si rezultat i zhvendosjes së vendeve të punës të shkaktuar nga globalizmi dhe zhvillimi i vullshëm teknologjik, ankthi dhe pasiguria që shkakton mungesa e një qëndrimi të qartë e parimor rreth migrimit, ndryshimeve shoqërore dhe të ardhmes të projektit europian, në një mjedis gjeopolitik asgjësues.

Është kjo arsyeja që në një pjesë të mirë të vendeve me të kaluar totalitare, liberalizmi nuk shihet më si një sistem vlerash e parimesh të fituar e mbrojtur me mund, por si një ideologji hipokrite që i shërben mbijetesës politike të elitave.

Prandaj, më shumë sesa një triumf i forcave konservatore, zgjedhjet presidenciale në Poloni janë një humbje për forcat e qendrës demokratike. Qëndrueshmëria e demokracisë liberale do të varet nga gatishmëria e tyre për të përfaquar një vizion të besueshëm të asaj që mund të ofrojë demokracia liberale në kushtet që imponon koha.

* Analiza është botim i Fondacionit "Friedrich Ebert"

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



VISAR ZHITI

Ferri nuk zbukurohet! Askush nuk ka të drejtë ta bëjë këtë për ata që ishin në ferr...

Burgu famëkeq i Spaçit, ku vuajtën mizorisht mijëra kundërshtarë të diktaturës enveriste, ku u pushkatuan apo u ridënuan rëndë ata që guxuan dhe u ngritën në revoltën e madhe, tashmë të futur në histori si ndër të paktat dhe më heroiket në të gjithë perandorinë komuniste, por e vetmja ku u ngrit Flamuri Kombëtar pa yllin e kuq, ku u vranë në minierat me kushte primitive, ku punonim si skllëvër, ku vdisnim urie e varrezë nuk kishte, banonim në fjetore pa asgjë, me tullat si luspa reptilësh, ku mbi 50 veta ngjeshur flinin në një dhomë-shpellë, me dyshekë kashte me tri radhë njeri mbi tjetrin, dritare te shkaterruara ku futej era e dimrit dhe shiu dhe vëzhgonte policia e çmendur, ku s'lejohehin rroba te tjera veç te burgut, as këpucë apo orë dore, kuzhina me tym si gazi në kampet naziste, etj, etj, një infermieri pa ilaçe, ku alkoolin e pinin policet me spiunët e tyre, me ata në sherbim të komandës, berberhane, tubi i ujit me vrma nga rridhte uji qe ngrinte akull, banjot pa dyer, shkallë dhe



zgëqe e thase, shtylla, altoparlantë që lehnin, kthina e takimeve të rralla me familjarët- e ndarë me hekura në nje dhomez sa kolibja e qenit të komandës, vendi i rrethuar me tela me gjemba një herë, dy herë, tre herë, katër herë, pesë... dhe male, përrenj me ujë të zi që dilte nga grykat e minierës si gojë lubish, kullat e dëndura të vendro-

jeve me trarë si përbindësja, etj, etj.

PSE?

- Një herë u bë krimi i madh, që u ngrit ai burg politik aq çnjerëzor...

- Së dyti, që e lanë të rrënohej, po prishej një dëshmi, po zhytej në mjegullat e harresës nga qeveritë...

MOS ZBUKURONI FERRIN!

Së voni- po duan ta bëjnë muze, shumë mirë, por jo ta tjetërsojnë, nëse po ndodh, jo ta zbukurojnë siç nuk ka qenë, të lihet ashtu siç e bënë etërit...

FILMI?

Po ndreqet për një film, po dëgjoj këto ditë të thonë, që do të xhirohet aty...

Skenarin e filmit, "Kryengritje në ferr", e kam shkruar unë, ish i burgosur i Spaçit, drejtimor i filmit dhe regjisor është Namik Ajazin, edhe ai ish i burgosur si unë, edhe babai i tij e mijëra shqiptarë, ndërkaq i është kërkuar shtetit nëpërmjet kryeministrit, cilitdo që do të ishte, (se s'e kemi emëruar ne, por është zgjedhur), të mbeshtesin filmin, si rrëfim i vuajtjes dhe i qendresës dhe kryengritjes tonë, për një Shqipëri të lirë, demokratike, euroatlantike, nder për historinë dhe krenari për popullin, që s'u gjunjzua i gjithë.

Shteti e ka për detyrë, i ka paratë, janë tonat, qoftë dhe nga ato të punës së papaguar të mijëra e mijëra të burgosurve politikë në dekadat e socializmit real në miniera,

tharje kënetash, hapje kanalesh, themelesh, ngritje pallatesh, taracash, stadiumesh e deri dhe aeroportin e kryeqytetit, etj, etj.

Shteti të dënojë krimin shtetëror të diktaturës enveriste, të nxjerrë kriminelët e saj politikë, t'i sjellë nga ku janë strehuar, jo t'i riciklojë, të ndëshkojë Realizmin Socialist dhe të keqen!

Shteti të mos zvarrisë apo të shmangë kulturën e kujtesës tonë!...

Të ribëjë burgun e Spaçit si muze ashtu si Aushvicin bota, si pjesë të kujtesës njerëzore, ashtu siç ishte, autentik, nëse s'mundet, të mos e zbukurojë, le t'ua thoshin etërve atëhere ta bënë siç do të donin tani - si makiash krimi të madh shtetëror, ferri është ferr, ai thjesht duhet të dëshmohet, të kujtohet si një e vërtetë e mynxyrshme, me qëllim që të mos përsëritet...

Këtë do të donim të bënim me filmin, nderim vuajtjes dhe martirizimit, gjakut dhe qendresës, ëndrës dhe së ardhmes...

Shteti të mos e pengojë, nëse nuk e mbështet dot artin e madh si pasuri kombëtare!

SONILA MEÇO

Në këtë vend, të vërtetat nuk zhbëhen më me dhunë. Zhbëhen me projekte. Me leje të përkohshme. Edhe qëllime të mira po deshe. Por sidomos me papërgjegjshmëri institucionale.

Nuk di si mund të 'stilohet' Spaçi me gëlqere si skenografi, kur në të është konsumuar akti më i pazëvendësueshëm i një tragjedie të vërtetë kombëtare.

Ministria e Kulturës deklaroi se ndërhyrja në ish-burgun e Spaçit është 'e përkohshme', se është bërë për një film që synon të risjellë Revoltën e vitit 1973, se gjithçka është bërë me 'përkushtim' dhe 'dashuri për historinë'. Por qysh kur historia paska nevojë të suvatohet për t'u treguar me dashuri? Si ruhet e vërteta duke e maskuar?

Spaçi nuk është një set i pazhvilluar filmik, që pret regjinë ta bëjë kuptimplotë. Ai është vetë kuptimi. Muret e tij nuk janë sfond, janë brendi. Janë dëshmi e një epoke, që ende nuk ka kaluar në filtrin e drejtësisë.

Në kujtesën kolektive edhe çarja e një muri është dëshmi. Edhe hiri mbi hekurat e një dëre ka statusin e provës.

Në Gjermani, kampet e përçmendimit nuk preken as me furçë e jo

SPAÇI: KUJTESA ËSHTË E SHENJTË



më me bojë. Në Poloni edhe për të xhiruar një film për Holokaustin përdoren imitime, jo ambientet origjinale.

Në Auschwitz nuk lejohet as të flasësh me zë të lartë. Në Buchenwald, çdo tullë ruhet si dëshmi.

Në Shqipëri, Spaçi lyhet. Me bojë të bardhë. Me gëlqere. Pa transparencë, heshtur, me 'marrëveshje gojore' me kryeministrin, siç thotë regjisor i një filmi ambicioz artistik mbi revoltën e Spaçit të vitit 1973.

Dhe shteti justifikon. Madje cilëson Sanço Panço kë nga dhimbja fundore e shpirtit a formimi intelektual reagon.

Artisti mund të shpikë. Historiani mund të rindërtojë. Por shteti nuk ka të drejtë ta 'lyejë' kujtesën.

Nëse qëllimi është të tregosh Revoltën e vitit 1973, ajo mund të xhirohet kudo. Në studio, në ambiente të ngjashme, me teknologji që sot riprodhon çdo gur, çdo hije, çdo qoshkëz.

Kjo nuk është çështje nëse filmi është i mirë apo i keq, i arrirë a i dobët. Sepse asnjë dyshim nuk kam në aftësitë e regjisorit e skenaristit, të talentuar, pesha të rënda të kulturës.

Kjo është një tjetër çështje: kush e kontrollon narrativën e së shkuarës në një vend pa drejtësi?

Spaçi nuk është hapësirë për të xhiruar. Nuk ka nevojë për regji. Ka nevojë për status. Për mbrojtje. Për muze. Dhe mbi të gjitha, për respekt. Dhe respekti nuk ndërtohet me bojë që do lahet pas xhirimeve. Respekti është të mos prekësh asgjë nga droja se mos zhduk edhe një gjurmë të vetme të së vërtetës.

Nëse ka një revoltë që sot duhet të dëshmohet, nuk është ajo filmike. Është revoltë ndaj mënyrës si po menaxhohet kujtesa kombëtare. Sepse një shtet që lyen Spaçin, ka humbur ndjeshmërinë për atë që ai përfaqëson: jo vetëm burgun fizik të disidentëve, por burgun e pazgjidhur të ndërgjegjes sonë kolektive. Të lejosh ndërhyrje pa plan konservimi, pa dokumentim të çdo cen-

timetri katror, pa një autoritet shkencor të pavarur, është jo thjesht papërgjegjshmëri, por abuzim me kujtesën.

Cila është garancia që nesër Spaçi nuk do përdoret për tjetër gjë? Për një serial? Një klip muzikor? Një fushatë marketingu?

Nëse e hap këtë derë sot, si do ta mbyllësh nesër?

Apo kujtesa kolektive është kthyer në pronë të përkohshme të çdo projekti me 'marrëveshje gojore' nga Kryeministri? Që me trashëgiminë kulturore ka bërë gjynahe.

Spaçi ka nevojë për një muze, jo për suvatim. Në vend që të ndërtojmë një qendër kombëtare të dokumentimit të krimeve të komunizmit, ndërhyjmë në mënyrë spontane, pa transparencë, pa debat publik dhe pa ndjeshmërinë që i takon një vendi të tillë.

Nëse doni të nderoni qëndresën, mos i vendosni grim torturës. Mos i jepni leje artit të bëjë atë që ende nuk ka guxuar ta bëjë drejtësia.

OLA XAMA

12 vjet më parë, një nga ngjarjet që u mbajt për javë me radhë në qendër të mediave ndërkombëtare ishte një video që tregonte se kryeministri i Anglisë David Cameron harroi në pub vajzën e tij 8-vjeçare.

Të gjitha mediat, përfshi dhe televizionin publik BBC News e raportoi si lajm, duke zbatuar të gjitha standardet mediatike. Video mbulonte imazhet dalluese të vajzës, tregonte ngjarjen dhe itinerarin si ndodhi dhe merrte ekspertë të cilët jepnin statistika sa të shpeshta ishin këto raste mes prindërve. Në fund ishte kontaktuar dhe çifti Cameron të cilët thanë “se u ndjemë të lehtësuar që e gjetëm e që kjo mund t’i ndodhë kujt do”.

Paralelisht një debat shumë i madh u shtrua për diskutim: A mundet që një fëmijë 8-vjeçar të vihet për 1 muaj në qendër të raportimeve vetëm se babai i saj është kryeministër? Përse nuk ishin subjekt i raportimeve të ngjashme mijëra fëmijë që u ka ndodhur e njëjta gjë? Përse duhet të rrezikohen trauma psikologjike te një minoren dhe të cënohej privatësia se si një familje kalon pasditen e saj?

Këto pyetje u rrëzuan me të tjera pyetje: A përbën interes për publikun fakti që kryeministri harron në pub fëmijën e tij? A kemi të bëjmë me një

ARROGANCA E ZONJËS RISTANI DHE DËSHIRA E ZYRTARËVE PËR NJË GAZETARI PA STANDARDE

kryeministër të papërgjegjshëm në qeverisje, kur ai është i tillë në jetën familjare?

Kjo ngjarje mu kujtua nga ajo që po ndodh orët e fundit me investigimin që transmetoi dje emisioni Pirranjat.

Kryetarja e komanduar e Bashkisë Tiranë, bashkëshorti dhe fëmija e saj, përdorin 3 automjete dhe 3 shoferë të paguar me paratë publike për nevoja personale. E vënë përballë këtij fakti, në vend që të kërkojë ndjesë apo të japë një sqarim njerëzor mbi rrethanat familjare që e kanë detyruar të bëjë këtë abuzim, znj. Ristani nis të fyejë gazetarin!

Asnjë ndryshim për nga niveli i arrogancës me parardhësin e saj, asnjë përgjegjësi-përkundrazi, bën deklarata që nxisin gjuhë urrejtje ndaj gazetarëve dhe misionit të tyre. Edhe pas transmetimit të emisionit nuk kishte reflektim, por kërcënim për hetime penale se i është përndjekur



dhe cënuar jeta private e fëmijës.

Nëse znj. Ristani do të ishte e shqetësuar për fëmijën, nuk do të përdorte atë gjuhë përpara kamerave se do të ç’edukonte fillimisht fëmijën e saj. Nëse do të ishte vërtet e shqetësuar për të, nuk do t’i mësonte se si vidhet dhe abuzohet me fondet e shtetit që minoren.

Por tema këtu nuk është morali që

tenton të na komunikojë ajo, e as morali që duhet t’i bëjmë ne një nëne, qoftë dhe kur është kryetare bashkie. Pika kryesore këtu është se me fondet publike fëmija i saj shoqërohet në shkollë, bashkëshorti në punë dhe vetë ajo në palestër.

Pra logjika e kësaj familje është që fëmijës nuk ka përse t’i shkelet privatësia se mamaja e tij ka post publik, por mund të përfitojë nga benefitet e

pushtetit dhe t’i falet çdo abuzim sepse është minoren!

Me sa pashë, Pirranjat kishin zbatuar çdo standard etike. Çdo fjalë në tekst ishte e faktuar me pamje dhe dokumenta, ishin pyetur të dyja palët, znj. Ristani dhe bashkëshorti dhe ishin shmangur pamjet që tregonin shoqërimin e fëmijës. Personalisht po të isha në vend të znj. Ristani në deklarata do të nxisja këto standarde gazetarie.

Çështja është se zyrtarët këtu te ne nuk duan që gazetaria të ketë standarde, sepse kur nuk ka standarde, pushteti e kontrollon më mirë. Në vitet 50’ në Angli, stafi i kryeministrit Clement Attlee e tregonte si anekdotë kur pyetej se cila ishte frika më e madhe e tij, “Gazetat në mëngjes-thonin.” Ndaj ky është dallimi mes medias së lirë dhe asaj të kapur: kur media është e lirë të rrëzon nga pushteti, e kur kapet të mban. Kush del nga kjo radhë sulmohet me çdo formë, ndonjëherë drejtpërdrejt nga pushteti e ndonjëherë duke përdorur vetë gazetarët.

IRENA BEQIRAJ

Një erë e fortë sjell një kurorë letre mbi kullotë. Dashi Luigj e vendos atë në kokë. Dhe në përputhje me rrethanat vetëshpallet Luigji I, Mbreti i Deleve. Me një kurorë në kokë, Luigji e di saktësisht se çfarë lloj mbreti do të ishte: erudit dhe i plot-fuqishëm.

Ai ndihet plotësisht i përshtatshëm për jetën mbretërore. Ndërsa anëtarët e mbretërisë vazhdonin të kullosin dhe të tresnin ushqimin, Luigji mban një fjalim në altoparant, ku i njoftoi se tani e tutje, të tjerët duhet t’i shërbejnë atij.

Ai dehet aq shumë nga pushteti sa mendon se në sundimin e tij duhej vendosur rregull, ndaj edhe vendosi të dëbonte te gjitha delet që nuk i ngjajnë atij.

Por Luigji nuk duhet të rehatohet shumë, pasi nuk mund të parashikonte afrimin e stuhisë. Erërat filluan sërisht

të frynë, duke ja hequr kurorën.

Luigji i I Mbreti i Deleve është një tregim për fëmijë i autorit francez Olivier Tallec, i cili me saktësi dhe thellësi të përpiktë, tregon një model sjelljeje mjerisht të njohur si ‘dehja nga pushteti’.

Të qenit i/e dehur apo i/e varur nga pushteti është më e dëmshme se çdo formë tjetër intoksikimi apo helmimi. Kjo varësi krijohet kur pushteti ushtrohet pa kufizime edhe në mungesë të plotë balance, pra kur ai konsiderohet më së shumti si e drejtë edhe jo si përgjegjësi.

Njerëzit në pushtet kur krijojnë varësi prej tij mbeten me dëshirë të plotë në një situatë për të cilën shpesh ankohen se mezi e durojnë. Por nëse depërtoni në ndjenjat e tyre të vërteta do të gjeni vetëm qurravitje për një të keqe pa të cilën nuk bëjnë dot. Fundja nuk është e lehtë të shkëputesh nga një angazhim nëse krijon varësi nga sh-përblimet e tij.

Njerëzit në pushtet kur krijojnë varësi prej tij, përfundojnë skllëvër vullnetarë të ambicies të tyre. Përpiqen të vishen bukur, të rimodelojnë fytyrat

ose trupin e tyre, por sërisht mbeten të shëmtuar sepse bëjnë zgjedhje të shëmtuara.

Përpiqen të diferencojnë veten nëpërmjet pozicionit, zyrës, elokucencës apo statusit, por brenda mbeten persona të vegjël, duke harruar se të pushtetshëm të bën mënyra sesi u qëndron parimeve, edhe mbi te gjitha sesi arrin të qeverisësh veten.

Pushteti nuk i bëri kurrë mbajtësit e tij të fuqishëm. Përkundrazi, ai zbuloi se sa të pafuqishëm, sa të dobët apo sa të frikësuar ishin në thelb.

Ky është mësimi më i vështirë për t’ju dhënë të rriturve sado inteligjentë apo mendje hapur të duken.

Ndaj francezi Olivier Tallec me humor, ndjeshmëri dhe ngrohtësi të jashtëzakonshme e ofron atë si një mësim të rëndësishëm që merret që në fëmijëri, kur për herë të parë prekim dinamikat e para të papërpunuara të pushtetit, të cilat përcaktojnë varësinë e dëshpëruar nga pushteti që shumë genie njerëzore provojnë në moshë madhore.

'LUIGJI I, MBRETI I DELEVE' DHE VARËSIA NGA PUSHTETI!

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?


AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545





SHISHA BAR PËR SHITJE

-I HAPUR PREJ
VITESH

-ME KLIENTELE TË
GARANTUAR

-I PAJISUR ME TE
GJITHA LIÇENSAT

-ÇMIMI SHUMË I
ARSYESHËM

-PËR MË SHUMË
INFO NA

KONTAKTONI

TEL: 07557565437



Gëzim Hilaj, gazetar ka ndarë historinë e tij dhe arsyen pse u nis për në Angli në mënyrë të paligjshme. Në një shkrim në "Uk.finance", ai shpreh se, të shkosh në Mbretërinë e Bashkuar ishte bërë një temë e përditshme bisedash për kafe për të rinjtë në Kukës.

"Në vitin 2022, kur rreth 12,500 shqiptarë kaluan Kanalin Anglez, kishte frikë se Kukësi do të mbetej një qytet fantazmë.

Në të njëjtin vit, e alarmuar nga këto shifra, qeveria e atëhershme konservatore njoftoi një projekt trevjeçar prej 8.4 milionë funtesh të quajtur Perspektiva të Reja për rajonin e Kukësit, me qëllim krijimin e më shumë mundësive të punës për të rinjtë me qëllim ndalimin e migrimit të paligjshëm", shprehet ai.

Por kjo marrëveshje nuk u bë, pasi Rama zgjodhi ti qëndroi besnik "martesës me Melonin".

Ai shprehet se Shqipëria ka nevojë për më shumë sesa politika performuese, por "Edi Rama sapo fitoi mandatin e tij të katërt si Kryeministër, pasi bëri fushatë me premtimin e madh për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian deri në vitin 2028. Në këtë kontekst, arritja e një marrëveshjeje të ngjashme me Mbretërinë e Bashkuar pas skemës së dështuar italiane jo vetëm që do të zemëronte shqiptarët, por gjithashtu mund të rrezikonte reputacionin e vendit në qëndrimin e tij diplomatik me BE-në."

Artikulli i plotë

Duke u rritur në Kukës në veri të Shqipërisë, një nga vendet më të varfra në Evropë, Gëzim Hilaj pa shumicën e të rinjve që ai njihnte të kalonin në Mbretërinë e Bashkuar me varka të vogla. Këtu ai argumenton se qendrat e kthimit të Keir Starmer nuk do t'i ndalojnë më shumë shqiptarë të bëjnë të njëjtën gjë.

Në vitin 2019, ndërsa unë po studioja shumë për të shkuar në universitet në një fshat të vogël në Kukës, në veri të Shqipërisë, pashë shumicën e shokëve të mi të klasës të largoheshin nga vendi. Shumica migruan ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar.

Në të vërtetë, të shkosh në Mbretërinë e Bashkuar ishte bërë një temë e përditshme bisedash për kafe për të rinjtë në Kukës.

"ARSYEJA E VËRTETË PSE TË RINJTË SHQIPTARË SI UNË PO VIJNË NË MBRETËRINË E BASHKUAR NË MËNYRË TË PALIGJSHME"



Me tre qytetet e saj, Tropojën, Hasin dhe Kukësin, i gjithë rajoni ka një popullsi prej rreth 60,000 banorësh dhe është renditur nga Eurostat si vendi më i varfër në të gjithë Evropën.

Në vitin 2022, kur rreth 12,500 shqiptarë kaluan Kanalin Anglez, kishte frikë se Kukësi do të mbetej një qytet fantazmë.

Në të njëjtin vit, e alarmuar nga këto shifra, qeveria e atëhershme konservatore njoftoi një projekt trevjeçar prej 8.4 milionë funtesh të quajtur Perspektiva të Reja për rajonin e Kukësit, me qëllim krijimin e më shumë mundësive të punës për të rinjtë me qëllim ndalimin e migrimit të paligjshëm.

Por që kur u largova nga qyteti im i lindjes në vitin 2022 për të studiuar dhe punuar në Londër dhe projekti ka përfunduar, asgjë nuk ka ndryshuar. Ndërsa ka pasur një ulje prej 95% të mbërritjeve të shqiptarëve me varka të vogla në Mbretërinë e Bashkuar, në Kukës njerëzit nuk janë më mirë dhe e njëjta ëndërr migrimi vazhdon. Familjet po rrisin fëmijë me shpresën se një ditë ata do të migrojnë në Mbretërinë e Bashkuar.

Ajo që supozohet të rriste punësimin mund të kategorizohet me siguri si një dështim, me 8 milionë paund nga paratë e taksapaguesve britanikë të shpenzuara kryesisht në një fushatë në mediat sociale që u thoshte njerëzve të qëndronin në vend, me pak ndikim të dukshëm.

Por për shqiptarët si unë, është gjithashtu një premtim i thyer. Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri në atë kohë, Alastair King-Smith, i tha medias lokale se projekti do të ishte një "iniciativë ambicioze në veri të Shqipërisë" dhe do të sillte mundësi në rajon: "Mos ikni ilegalisht! Mesazhi im për prindërit dhe anëtarët e familjes është se kriminelët dhe trafikantët po shfrytëzojnë fëmijët tuaj dhe po i detyrojnë ata të futen në botën e krimit. Ju lutemi punoni me ne për të krijuar shpresë dhe mundësi për këtë rajon", tha ai.

Projekti është emblemik i mënyrës se si politika e Mbretërisë së Bashkuar shumë shpesh thotë fjalë dhe jo veprime.

Plani i dështuar i Starmer për "qendrat e kthimit"

Dhe problemi vazhdon. Muajin e kaluar, Keir Starmer u bë kryeministri i parë i Mbretërisë së Bashkuar që vizitoi ndonjëherë Shqipërinë, ku, gjatë një konference të përbashkët për shtyp, ai njoftoi plane për të ngritur qendra kthimi për azilkërkuessit e dështuar në vendin e Ballkanit Perëndimor. Duke pasur parasysh rezultatin e projektit të mëparshëm të financuar nga Mbretëria e Bashkuar, ideja e qendrave të kthimit duket e shkëputur nga realiteti ligjor dhe politik i Shqipërisë. Nëse 8 milionë paund nuk mund të ndryshonin as atmosferën në një rajon, si mund të kishin sukses qendrat e kthimit me forcë në të gjithë vendin?

Por ka një problem më të madh. Kryeministri shqiptar Edi Rama tha se Shqipëria nuk do të marrë pjesë në një skemë të tillë për shkak të "besnikërisë së saj ndaj martesës me Italinë", duke iu referuar marrëveshjes së migracionit Itali-Shqipëri të nënshkruar në nëntor 2023 - një marrëveshje e diskutueshme për të ndërtuar qendra paraburgimi në Shqipëri, ku do të përpunoheshin deri në 36,000 emigrantë jo-BE në vit.

Propozimi i Italisë ishte i thjeshtë: në vend që të mbante azilkërkuessit në tokën italiane, do t'ia jepte paraburgimin dhe përpunimin e tyre Shqipërisë. Por pothuajse menjëherë, organizatat e të drejtave të njeriut dhe ekspertët kushtetues ngritën alarmin.

Në nëntor 2024, qeveria italiane në Romë bllokoi zbatimin e marrëveshjes Itali-Shqipëri, duke argumentuar se skema mund të zbatohet ligjërisht vetëm për emigrantët që vinin nga "vende të sigurta". Është e drejtë të thuhet se skema nuk ka shkuar siç shpresonte kryeministria italiane Giorgia Meloni, me vetëm 49 refugjatë të dërguar në Shqipëri deri më tani.

Shqipëria ka nevojë për më shumë sesa politika performuese

Ndërkohë, në vetë Shqipërinë, krahu i majtë Edi Rama sapo fitoi mandatin e tij të katërt si Kryeministër, pasi bëri fushatë me premtimin e madh për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian deri në vitin 2028.

Në këtë kontekst, arritja e një marrëveshjeje të ngjashme me Mbretërinë e Bashkuar pas skemës së dështuar italiane jo vetëm që do të zemëronte shqiptarët, por gjithashtu mund të rrezikonte reputacionin e vendit në qëndrimin e tij diplomatik me BE-në.

Ndryshe nga Italia, Mbretëria e Bashkuar nuk është më anëtare e BE-së dhe nuk ndan të njëjtat korniza ligjore ose detyrime rajonale.

Çdo përpjekje për të deportuar azilkërkuessit e dështuar në Shqipëri ka të ngjarë të kundërshtohet si në gjykatat vendase të Mbretërisë së

Bashkuar ashtu edhe nga mbikëqyrësit e të drejtave të njeriut. Dhe ndryshe nga Italia, Mbretërisë së Bashkuar i mungon i njëjti kapital politik në Shqipëri.

Nëse Italia, një anëtare themeluese e BE-së me lidhje të thella me Shqipërinë, nuk mund ta zbatojë pa probleme një skemë kaq të diskutueshme migracioni, si mund të presë Mbretëria e Bashkuar të bëjë më mirë? Plani britanik për të ngritur qendra kthimi për azilkërkuessit e refuzuar përballet me të njëjtat sfida ligjore - dhe ndoshta edhe më të vështira.

Dhe kjo pa përmendur ato logjistike. Shqipëria tashmë po përpiqet të ofrojë mbështetje për riintegrimin e të kthyerve të saj. Çfarë lloj infrastrukture ose shërbimesh do të ofronin "qendrat e kthimit" në Mbretërinë e Bashkuar? Nëse projekti i Kukësit është diçka për t'u marrë parasysh, mund të presim shumë pak.

Nëse Mbretëria e Bashkuar dëshiron vërtet të ndalojë migrimin e parregullt nga Shqipëria, ajo duhet të braktisë politikën performative dhe të investojë në partneritete reale.

Kjo do të thotë të ndihmojë në zhvillimin e programeve profesionale afatgjata të lidhura me mungesat e fuqisë punëtore në Mbretërinë e Bashkuar, skemat e punës sezonale ligjore dhe grantet që shkojnë direkt te qeveritë lokale, jo te fushatat e marrëdhënies me publikun.

Dhe mbi të gjitha, kjo do të thotë ta trajtojmë Shqipërinë jo si një mjet politikash, por si një partner të barabartë.

Sepse ajo që kemi parë vazhdimisht - nga dështimi prej 8 milionë funtesh në Kukës deri te marrëveshja e dështuar Itali-Shqipëri - është se migrimi nuk mund të zgjidhet duke i dhënë përgjegjësi një tjetri.

Ai kërkon llogaridhënie, integritet ligjor dhe besim. Tani për tani, Britania ka humbur para në Shqipëri dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë politico.al

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



POROSISNI BANNER PËR BIZNESIN TUAJ



**PVC BANNERS
MESH BANNERS
PREMIUM ROLLER
PULL UP ROLLER**



Na kontaktoni:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

ROMEO GURAKUQI

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës – një qytet me rëndësi të veçantë shpirtërore dhe kombëtare për shqiptarët. Për dekada me radhë, përmes valëve të Radios dhe Televizorit të Prishtinës, shqiptarët nga të gjitha anët kanë ndjekur rrahjet e pulsit të pjesës tjetër të kombit, dëshminë e mbijetesës dhe rezistencës kulturore. Në periudhat kur Rilindësit dhe ndërtuesit e shtetit shqiptar ishin të ndaluar në Shqipëri, Prishtina mbeti një hapësirë e hapur frymëzimi për lirinë e Dardanisë. Intelektualët, shkrimtarët, studiuesit dhe historianët e Kosovës – rilindësit e rinj të kësaj ane të Gegnisë – pavarësisht mungesës së lirisë politike, përbënin një burim frymëzimi edhe për Shqipërinë e izoluar nga diktatura. Në Kosovë ruhej ende e pastër dhe e gjallë lidhja me Shqipërinë Tradicionale, e cila përtej kufirit ishte bërë objekt ndalese. "Lahuta e Male-sise" ishte libri i shenjtë i Kosovës ne ruajtjen e identitetit. Kjo ruajtje e autenticitetit kombëtar ndërthurej me një formim intelektual thelbësish të ndryshëm nga ai i Shqipërisë, ku për një gjysmë shekulli universi akademik evropian dhe ai i eterve te



kultures kishte qenë i ndaluar. Takimi im i parë me studiuesit e Kosovës – që, ia dolën të marrin pjesë në forumet shkencore në Shkodër dhe Tiranë, në kohën kur Kosova ende ndodhej nën pushtim – mbetet një

përvijë e paharrueshme dhe e pashlyeshme për mua. Sot Kosova është e lirë. Dje u ktheva nga Prishtina me shpresën se ajo frymë e dikurshme do të ruhet, do të zhvillohet dhe do të ngri-

PRISHTINA, NJË QYTET ME RËNDËSI TË VEÇANTË SHPIRTËRORE DHE KOMBËTARE PËR SHQIPTARËT

het më lart në funksion të misionit të një shteti modern evropian.

Kosova ka pasur dhe ka personalitete me ndikim të madh në fushën e historiografisë, me autoritet të pakontestueshëm në prodhimin e dijes shkencore. Ata kanë ndërtuar një traditë të konsoliduar të përgatitjes së brezave të rinj të studiuesve, duke lënë pas një trashëgimi të gjerë. Reputacioni i tyre është ndërtuar mbi përkushtimin ndaj standardeve akademike dhe mbi një punë kërkimore të palëkundur.

Unë mendoj se periudha e tranzicionit nuk duhet të çojë në harrimin e kësaj trashëgimie, dhe as të hapë rrugë për krijimin e "padrinove" që ushtrojnë kontroll arbitrar mbi shkrimin shkencor të historisë, duke përzgjedhur dhe vendosur në mënyrë të njëanshme mbi vlerën e veprave kërkimore.

Në kontekstin e vendeve post komuniste, raporti midis pushtetit, autoritetit akademik dhe prodhimit të dijes është shpesh i ngarkuar me tensione strukturore dhe personale. Prandaj, në përputhje me parimet e

epistemologjisë bashkëkohore, lejimi i krijimit të figurave me pushtet arbitrar vendimmarrës është në kundërshtim me frymën e kërkimit shkencor të lirë dhe të verifikueshëm.

Duhet të kemi parasysh se historiografia moderne nuk është ndërtuar mbi hierarki autoritetesh, por mbi dialog, kritikë të ndërsjellë dhe rishikim të vazhdueshëm të tezave në dritën e burimeve të reja dhe qasjeve teorike të përparura. Kulti i autoritetit personal bie ndesh me parimet themelore të shkencës: një punim është i vlefshëm jo sepse e pohon një autoritet, por sepse është ndërtuar mbi metoda të qëndrueshme, burime të mirëpërdorura dhe analizë të thelluar.

Republika mendoj se duhet të vazhdojë të investojë në zhvillimin e shkencës mbi këto parime, por njëkohësisht duhet të jetë e kujdesshme për të identifikuar nëse aktorë të caktuar financojnë tinzisht me synim të deformojnë këtë rrugë modernizuese dhe europianizuese të institucioneve që janë themeluar për të përmbushur një mision të lartë kombëtar dhe qytetar.

BETI NJUMA

“Unë kam bërë një skenar filmi me kërkesë të regjisorit Namik Ajazi. Ndodh rrallë në botë që dy autorë të burgosur bëjnë një film, regjisorin dhe skenaristin. I është kërkuar institucioneve përgjegjëse të financohet një dëshmi, një vepër arti sepse duhet të shpëtojmë nga monologu, nga të rrëfyerit vit për vit të të njëjtës gjë, siç bën Izraeli me Holokaustin. Regjisorin ka kontaktuar kryeministrin i cili i ka premtuar, meqenëse duhet ribërë burgun për të xhiruar, me këtë rast si të thuash, një rrugë dhe dy punë, Spaçi ose Qafë Bari do të kthehen në një muzeum”.

Gjatë një interviste për Ora e Betit, në 23 maj të 2023, ku kujtuam dy revoltat e përgjakshme të Spaçit dhe Qafë Barit, shkrimtari Visar Zhiti më foli për herë të parë për projektin e një filmi kushtuar burgjeve komuniste në Shqipëri.

Ajo që nuk dinim, madje as vetë skenaristi Zhiti, ishte se kjo marrëveshje verbale mes kryeministrit Rama dhe regjisorit Ajazi u bë zanafilla e një ndërhyrjeje restauruese në Spaç, një monument kulture i kategorisë së dytë.

Denoncimet me foto dhe pamje nga aktivisti Arnen Sula e të përhapura me shpejtësi në rrjetet sociale, treguan se ishte suvatuar dhe lyer me bojë të bardhë një prej godinave të kampit, ndërsa janë planifikuar ndërhyrje në vlerë mbi 100 mijë euro në disa godina të tjera që i kanë shpëtuar rrënim, përfshirë edhe tarraca e apelit.

Këto ndërhyrje të bëra nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, që në emër të restaurimit kanë dëmtuar kujtesën historike në kampin më të egër komunist në Shqipëri janë kundërshtuar nga ish-të burgosur politikë, aktivistë të shoqërisë civile arkitektë dhe studiues pasi rrezikojnë të deformojnë të kaluarën dhe ta manipulojnë atë. Reagimet kundërshtuese dhe një peticion kanë ngritur alarmin jo vetëm për mungesën e transparencës institucionale, por se ndërhyrjet e bëra pa një konsultim publik dhe plan konservimi po shkatërrojnë identitetin e kësaj hapësire kujtese.

Sot, shumë ish-të dënuar të regjimit komunist dhe aktivistë protestuan në burgun e Spaçit në Mirditë.

Sot në Spaç, kundër shkatërrimit të historisë së burgut kamp, në përpjekje për të mbrojtur atë çfarë ka mbetur legjenda e gjallë e burgjeve, Fatos Lubonja tha se menca dhe kuzhina tashmë janë shkatërruar ndaj asnjë gur nuk duhet prekur më.

Reagimi i djeshëm i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Gonxhe, në vend që të kërkonte faljen për ndërhyrjen e pavend foli për “tymnajë”, për fabul të sajuar mbi “prishje të kujtesës dhe Sanço Panço të politikës së vjetër. Por me sa duket ministri qëllimisht “harron” se në ballë të zërave kundër kësaj ndërhyrjeje nuk janë dy personazhe periferikë të Servantesit, por dy të mbijetuar të burgjeve komuniste si Visar Zhiti dhe

SPAÇI, KRIMI QË NUK RESTAUROHET!



Fatos Lubonja, pa harruar edhe shumë të tjerë që janë shprehur publikisht. Do t'i lutesha ministrit që të lexonte shkrimin e Zhitit “Mos zbukurini ferrin” që së paku të heshtte, duke mos përdhosur dhimbjen e tij! E këtij kori do të kisha dashur t'i bashkohej edhe zoti Ajazi.

Sepse në fakt Spaçi nuk është thjesht një kamp me ca godina të rrënuara por një plagë ende e hapur e shoqërisë shqiptare. Është kujtimi i gjallë i atyre që u përballën me dhunën e regjimit

totalitar dhe një dëshmi që flet me gjithçka, me muret, qelitë e ftohta, me telat me gjemba, me heshtjen e atyre që nuk dolën të gjallë nga ai ferr. Në një shtet serioz, restaurimi i një vendi të tillë kujtese do të bëhej me transparencë, me pjesëmarrjen e viktimave, me përkushtim për të ruajtur autenticitetin e dhimbjes që ai mbart. E lyer me bojë të bardhë, një nga godina e kampit ku është ndërhyrë nuk ka më asnjë gjurmë të së shkuarës si dëshmi e vuajtjeve të qindra të burgosurve.

“Kulla e rojës, – siç tha me ironi Fatos Lubonja, -ngjan më shumë me një produkt hollivudian sesa me realitetin që ai dhe qindra bashkëvuajtës kanë përjetuar për vite të tëra.”

“Të mos lëvizet asnjë tullë! – këmbënguli me dhimbje Dashamir Biçaku në studion time, gjatë emisionit për këtë çështje. “Ishte burg, jo hotel” tha familjari i një ish të dënuar për gazetaren Enkelejda Mema në Euronews. Në fakt terrori i komunizmit nuk mund të mbulohet me suva dhe as të lyhet me bojë të 2025-ës. Nuk mund të restaurohet e kaluara për hir të një projekti filmi.

Në një vend dhimbjeje dhe kujtese si Spaçi kjo ndërhyrje është një dhunim i dytë ndaj viktimave për ta bërë krimin të pranueshëm. Sot rrezikojmë të harrojmë jo vetëm të shkuarën, por edhe kuptimin e saj. Spaçi nuk ka nevojë për dekor, skenografi dhe efekte. Spaçi ka nevojë për ruajtje dhe respekt! Spaçi ka nevojë për ndalimin e menjëhershëm të çdo ndërhyrjeje deri në miratimin e një plani tërësor konservues ku fjalën e fundit duhet ta thonë ata pak ish-të burgosur politikë që kanë mbetur gjallë dhe specialistët e trashëgimisë.

Sepse Spaçi nuk është skenë filmi. Është dëshmi krimi. Dhe krimi nuk lyhet me bojë, e as mund të restaurohet!

SI TA ZBULOSH NJË KRIPTO RAMIST

ANDI BUSHATI

Tek mitingu i pasfitores në sheshin Skëndërbej Edi Rama lëshoi një urdhëresë, e cila, që prej asaj dite është shndërruar në refrenin e të gjitha studiove televizive; të asaj që përsërisin opozitarët fallco, që kanë gjetur një formë mbijetese në këtë regjim; të asaj që thonë gjoja të pavarurit, të cilëve u ka mbetur ende një lloj cipe; apo të idiotëve të dobishëm që përtojnë të vënë trurin në punë.

Në atë fjalim kryeministri tha se ky popull ka vendosur “të mos ndryshojë qeverinë pa ndryshuar më parë opozitën” e këtij vendi. Që nga ky moment “zbërthimi” i kësaj direktive është shfaqur në publik në mënyra të ndryshme. Prandaj ndoshta i’ a vlen ti reshtosh këto “argumente” për të dalluar ramistin e fshehur që qëndron pas tyre.

1 Alibia: “Nuk fitoi Rama, humbi Berisha”

Mbështetësit e idesë se patëm zgjedhje normale kapen si i mbytur pas fijos së barit për të thënë se populli nuk zgjodhi Ramën, por dënoi Berishën. Ata e përmendim me pathos dhe qëmtojnë çdo argument për të vërtetuar këtë tezë. Por ata “harrojnë” se pas 12 vjetësh në pushtet dhe zbulimit të një gjysëm dizine hajdutësh në qeveri, Rama mori më shumë vota se ndonjëherë në histori (plot 856 mijë) që si pati fituar as në 2009, as në 2013, as në 2017 as në 2021. Pra fitorja e Ramës nuk vjen vetëm si pasojë e shkalafitjes së opozitës, por edhe për faktin e thjeshtë se me metodat e tij, ai arriti numër rekord votash në favor të PS.

2-Alibia e një PD-jë të dobët

Një tjetër argument është ai i një PD-je të dobët, të pa organizuar dhe që humbi votues, gjë e cila prodhoi bymbjen elektorale të kundërshtarit.

Po, në pamje të parë, këto janë të vërteta, por e rëndësishme është të kuptohet se kryeministri nuk qe krejt i pagjisht në krijimin e këtyre simptomave, madje u angazhua personlisht për inflamimin e tyre. Tashmë është fakt edhe sipas deklaratave të administratës së re amerikane, se shpallja Non Grata e Berishës ishte një akt i lobuar. Po ashtu edhe luftimi i saj me metoda alla McGonigal nuk përbën më dyshim.

Po të mos harojmë se këto goditje të sponsorizuara që vinin nga jashtë ndikuan edhe që sistemi i drejtësisë së re ta mbante pothuajse gjysmën e mandatit pa vullë, pa financa dhe të pa njohur ligjërisht PD, se lideri i saj u izolua për një vit pa mundur të ushtrojë aktivitetin e tij normal, kuptohet më lehtë se pse u tkur PD. Pasi ajo nuk konkuronte me një parti rivale por me një shtet të tërë.



Pra dhe argumenti që PD qe e dobët nuk mund të shihet jashtë projektit për të shkallmuar një fushë loje të barabartë për të gjithë.

3 Alibia e “të vegjëlve”

Mbrojtësit e zgjedhjeve normale flasin për fajin e Berishës, që bashkë me Ramën, ka kurdisur një sistem zgjedhor që nuk favorizon partitë e vogla.

Po, është e vërtetë, që të dy sëbashku votuan në 2008 një sistem të padrejtë që penalizon forcat e reja dhe i transferon votat e tyre tek dy të mëdhenjtë. Por fakti se “i vogli ushqeu të madhin”, nuk mund të arsyetojë gjithçka.

Krahas fajit të një Saliu të pandreqshëm nuk duhet të harrojmë se partitë e vogla nuk u penalizuan vetëm nga kjo. Ato së bashku qenë gjithashtu viktimat e një gare të pabarabartë, të përcaktuar nga kamikazllëku i administratës politike, nga patronazhistët që përdornin vjedhjen e të dhënave personale nga banditët lokalë që prodhuan fenomene si Sara Mila e Arkend Balla.

4 Alibia me relativizimin e bandave

Personazhet e mësipërme janë simbole të votës të grumbulluar nga pakti i pushtetit me bandat. Por, po ti shohësh ramistët e maskuar, sa herë

që fjala shkon tek Troplinët, Suel Çela, apo Bajrat, ata i shmangen debatit sikur kjo të jetë një tabu. Me siguri që më tepër se frika nga personazhet e mësipërme i tremb ideja e rrëshqitjes në një terren ku s’ka asnjë mundësi që teza e zgjedhjeve normale të dalë e fituar.

5 Alibia e vjedhjes për hobi

Po të njëjtët reken të argumentojnë se parregullësi, shantazh, blerje të votës mund të ketë pasur. Por menjëherë pas kësaj shtojnë se kjo nuk ka ndikuar në rezultat. Por, duke thënë këtë, asnjëherë nuk shtrojnë dilemën që rrjedh natyrshëm: “ç’ duhet të vjedhë dikujt që s’ka nevojë ta bëjë”.

6 Alibia e zhdukjes së partisë së Metës

Shumica e atyre që gjejnë tkurrjen e votës opozitare, si pretekst kryesor për të justifikuar këto votime, bëjnë sikur harrojnë një gjë. Në këtë thes mungojnë 100 e ca mijë votat që LSI-a kishte në 2021 të cilat qenë dy fish më shumë në 2017.

Por ky asgjësim nuk u arrit vetëm me blerjet masive që Rama bëri në radhët e hierarkëve të kësaj partie, që tashmë janë dëshmuar edhe me video të neveritshme. Ajo lidhet edhe me ultimatumet që kryeministri i bëri SPAK-ut nga kongresi i PS-së: “durimi ynë për prangosjen e Metës po sosit”. Dhe atë që nuk e bënë dot socialistët

duke prodhuar edhe projektligje absurde për të nxjerrë nga politika “spionët”, e bëri SPAK-u duke burgosur liderin e partisë së dytë opozitare.

Pra kur analizojmë reduktimin e votave opozitare nuk kemi se si të harrojmë edhe drejtësinë e re, që ka punuar sinkron me PS-në.

7- Alibia e dashurisë për një palë hajdutë

Kripto ramistët lodhen duke analizuar se shqiptarët nuk janë aq budallej sa të votojnë më për një parti si e Ilirit apo Monikës, e cila u zhdruk nga harta politike e vendit, pasi SPAK po i heton si të korruptuar.

Por, ata harojnë të përdorin të njëjtën peshë dhe të njëjtën masë në gjykimin e të tërë faktorëve në lojë. Pasi ndryshe si shpjegohet që goditjet e çunave të Dumanit për Veliajn, Beqajn, Ahmetajn, Kokën, Tahirin nuk patën asnjë impakt mbi votën pro PS-së? Alibia se elektorati përbuz ‘hajdutët’ e njërës palë dhe dashuron ata të tjetrës është e papranueshme edhe për një logjikë minimale.

8 Alibia e vjedhjes brenda llojit

Flamurtarët e mbrojtjes së një procesi normal detyrohen të pranojnë me gjysëm zëri se ministra ngandonjëherë edhe fare anonimë arritën të mundin, në listën e hapur, figura të PS

si ish kryeministra.

Por, ata ndalojnë vetëm tek konstatimi i këtij paradoksi pasi nuk guxojnë të pohojnë se kjo makineri kriminalo-administrative që rrëmbëu votat brenda llojit, pasi është vënë në punë nuk mund të mos jetë përdorur si armë edhe kundër rivalëve opozitarë.

9 Alibia: Fajin e kishte La Civita

Pjestarët e së njëjtës kategori thonë me gojën plot se njerëzit nuk i përtpynin dot më përrallat me lobime që donin ti gënjenin me MAGA-n e La Civitës apo mundësinë e heqjes së Non Gratës. Ndoshta kanë të drejtë.

Por po të njëjtët që përdorin këtë arsytim për të goditur rezultatin e opozitës në zgjedhje e konsiderojnë normale atë që Rama ka bërë me McGonigalin, dhëndrrin e Trumpit në Sazan apo shitjen e sovranitetit të vendit tek Meloni. Kontradikta e tyre është se lobimi për dikë funksionon ndërsa tjetrit i kthehet në boomerang.

10 Alibia e përhershme: “Fajin e kishte, e ka dhe do ta ketë Saliu”

Pra shkurt, është e lehtë të dallohet një ramist i kamufluar sepse ai do gjejë një formë më të sofistikuar për të përsëritur refrenin që lideri i tij shpirtëror këndon prej një dekade e gjysëm për të justifikuar ç’do gjë: “fajin e ka Saliu”.



Dotech
website 

**AKOMA NUK KENI NJË
WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ ?**

**Akoma nuk jeni
rregjistruar në Google?**

**Për çdo konsultim mund të
vini në çdo kohë në zyrat tona**

NA KONTAKTONI

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**

- 
- **Web Design**
 - **Logo**
 - **Business Cards**
 - **Banners**



**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**

VETON SURROI

Një fjali e gjatë për kandidatët e Prishtinës

Më thotë se po quhet "Aktash" kjo lagje tash dhe mund të jetë fare lehtë që të gjithë të tjerët që nuk jemi si unë dhe ai, të lindur në qytet, ta marrin si të mirëqenë këtë emër, por ne e dimë se si quhet, sepse kemi ecur këtyre rrugëve verës dhe dimrit, e dimrit në veçanti ka qenë vështirë, sepse të gjithë dimrat e kaluar, në të gjitha vendet ku ka rënë borë, ishin më të ftohtë, sepse ne ishim fëmijë e të vegjëlve i ftohti i atëhershëm ishte më i ftohtë, ndërtesat ishin më të mëdha dhe çdo kajsi e domate ishte më e shijshme, këtë e dimë me siguri unë dhe miku im që po ngjitemi rrugës përpjetë kah Përmendorja, se aty tek emri dallon kush është i lindur këtu e kush jo, sepse nuk i thotë kush te Përmendorja, por tash kanë filluar ta quajnë te varri i Rugovës e disa të tjerë te varri i Demaçit, derisa të dalë ndonjë pikë reference, ndonjë hotel i madh, qendër zbavitjeje, ndërtesë shumëkatëshe, që do të jetë çudia arkitektonike e radhës të marrë e gjithë lagjja emrin sipas saj, si kur u kthye Ali Dybeshi prej shkuarjeve në Itali me disa prej djemve të kësaj lagjeje e disa prej Kacallarëve, atje ku punonin disa punë që nuk bënë të përmenden në publik, por që kanë qenë bukur më të padëmshme se shumë të tjerat që u bënë më vonë nga ata që merreshin me të bardhë apo me disa prej atyre që erdhën pasluftë e u bënë pushtet dhe merreshin me çdo

të zezë, se pastaj lagjja u bë e njohur si te Kafja e Dybeshit, mbante turshi të mira dhe besonte se ka mish të mirë, por nuk kishte kush ta vërtetonte këtë punë, se të gjithë që shkonin te Dybeshi ishin aty pasi mbylleshin të gjitha lokalet e tjera dhe ngase Dybeshi mund ta ketë pasur ndonjë rrëfim prej Italisë që duhet treguar apo ritreguar, rrëfime që i mori më vonë me vete në det atëherë kur u fundos ajo anija që u nis prej Vlorës për në Brindisi dhe kur valët nxorën në breg asgjë tjetër prej Ali Dybeshit pos letërnjoftimit të tij, të KSA të Kosovës, ende shkruante shqip në të apo kështu dukej në incizimin që e jepte Euronews, se nuk doli në ndonjë televizion tjetër e ndoshta mund të ketë dalë, por ne kaq kishim mundësi të shihnim në TV, ishin kohë kur u bënë disa vjet prejse ishte mbyllur me dhunë televizioni i Prishtinës, në gjuhën shqipe fliste Hajrije Spikerica për gjithsej gjysmë ore, më pak fliste shqip Hajrije Spikerica se Radio Pekini, por për Radio Pekinin nuk kishte dëgjuar kush, sepse ishte

koha e antenave satelitore dhe koha kur TV në gjuhën serbe vendosi se duhej të kombinonte të gjitha ato rrëfime të pornografisë politike që mbulonin të ashtuquajturin program informativ me pornografinë jopolitike, atë që në Perëndim etiketohej me XXX, por këtu nuk kishte nevojë për etiketa, sepse të gjitha ishin të lejuara prej momentit kur u lejua vrasja e fëmijëve, turpi nuk kishte nevojë për ndonjë shenjë të veçantë dhe këtë e dinte edhe Bata kur e çeli shtëpinë e vet publike te Parku, së paku u përpoq të kishte arsyetimin se ai në fakt po institucionalizonte diçka që bëhej fshehtas aty përballë te Parku, apo se ishte më pak turp çka bëhej tek ai nën dritat e kuqe se çka bëhej gjithandej, se kishin filluar luftërat e çdo gjë është më pak jomorale se lufta apo se ky ishte i vetmi vend ku vinin edhe shqiptarët e serbët pa ndonjë diskriminim, sepse prostitucioni nuk bënë dallime siç bënë politika, por në fund edhe bota u dorëzua, sepse pati një ofertë më të mirë dhe e shndërroi lokalitë në një lloj hoteli

të tipit të mbyllur për diplomatët që kuptonin të kaluarën e këtij vendi vetëm kur mbërrinin për të fjetur në dhomat rozë me perde zemrash dhe pasqyrë në tavan, një moment përfundimtar ballafaqimi me veten pas një dite të gjatë ballafaqimi me realitetin e Prishtinës dhe të kësaj lagjeje me shumicë dërrmuese shqiptare, me çdo shtëpi që kishte një rrëfim të vetin për të treguar, por që nuk kishte kush të dëgjonte, sepse nuk kishte aq shumë diplomatë sa kishin halle këta njerëz e çdonjëri prej tyre mendonte se halli i tij është më i madh se ai i tjetrit, që të gjitha të rrëfyera pashmangshëm te Furra e Kacallarëve, ku mblidheshin çdo mëngjes për të këmbyer informata sepse, siç dihej, nga të gjithë ata vetëm informatat që këmbehen mes njerëzve që njihen mes vete janë për të besuar, se kjo gjë u pa edhe gjatë bombardimeve kur radiot e televizionet e huaja tregonin sa bomba janë hedhur, por vetëm te furra mund të kuptohej se kush prej shqiptarëve është vlarë dhe jo prej bombave, por prej policëve e

ushtarëve dhe nga furra ktheheshin me bukën ende më të mirë të misrit që është bërë ndonjëherë, sepse asnjë gjë nuk është e shijshme sa ato që fillon të jesh i vetëdijshëm që vlejnjë, sikur jeta a ndihma, a kujdesi familjar, a një fjalë e mirë, a shpresa se do të bëhet më mirë, a buka e misrit e Kacallarëve, ajo që nuk blihej në Ramazan, sepse nga aty dilnin pitalkat më të mira, madje edhe kur nuk ishte Ramazan ishin të mira ato që bëheshin gati për qebaporet e mëhallës që fillonin të ngrohnin skarën prej pesë e diçka të mëngjesit, kur rrugës nga Përmendorja poshtë ndiheshin gjithnjë e më shumë hapat e njerëzve që niseshin për në punë dhe pak më vonë e shokëve tanë që niseshin për në shkollë, gjithnjë me këpucë pak më të baltosura se ne, shenjë e pashmangshme e të qenit pjesë e Lagjes së Muhaxherëve, aty ku pleqtë dinin të flisnin për mëngjesin e një dite të vitit 1878, kur familja u desh të bëhej gati që brenda një ore të braktiste shtëpinë e të nisej për Kosovë, aty ku fëmijët harronin rrëfimet e


pleqve çdo ditë të dimrit me akull, sepse ishte pjesa më e mirë e qytetit për t'u lëshuar me saja dhe aty ku shoku im dhe unë në të hyrë të mëhallës dinim se kishim hyrë në një territor të veçantë nga i cili dalloheshim me tisin e lehtë të diferencës së ardhjes së familjeve tona në qytet, të faktit se prindërit tanë kishin ardhur prej viseve të tjera të Kosovës, nuk ishin teknikisht muhaxherë, edhe pse që të gjithë ne në qytet disi kishim ardhur prej dikah, vetëm prishtinasit nuk kishin ardhur prej kurrkund, ata kishin shkuar, nuk kishin mbetur pothuajse të këtyllë këtu dhe çdoherë më bie në mend ndonjë prej atyre që i dija për prishtinali para zgjedhjeve komunale, sikur tash me këto që mbahehen në tetor e kur Prishtina duhet të zgjedhë një kryetar komune, ndoshta ndonjë që mund të kuptojë se ky qytet si çdo tjetër është rrëfim dhe se ti duhet të bëhesh kryerëfimtari e jo ndërprerës i rrëfimeve apo heshtës i tyre.

RRËFIMI PËR NJË LAGJE DHE KRYETARIN RRËFIMTAR



NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas

 **07774222062**

 **07878335000**

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

